



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti i vetëvlerësimit

2018-2019

Komisioni i vetëvlerësimit

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE | DHJETOR 2019

Përmbajtja

1.	Hyrje dhe konteksti institucional.....	5
2.	Raporti i Vetëvlerësimit dhe Procesi	6
3.	Të arriturat.....	7
4.	Mundësitë.....	9
5.	Sfidat.....	10
6.	Struktura: fakultetet dhe qendrat	11
6.1	Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë.....	11
6.2	Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore	12
6.3	Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore	13
6.4	Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit	13
6.5	Fakulteti i Drejtësisë.....	14
6.6	Qendra e Gjuhëve	14
6.7	Qendra E-Learning.....	15
7.	Sigurimi i Cilësisë	16
8.	Mësimdhënia dhe të mësuarit	17
8.1	Programet dhe statusi.....	17
8.2	Regjistrimi i studentëve.....	17
8.3	Kalueshmëria e studentëve	19
8.4	Qendra e karrierës dhe punësueshmëria.....	20
8.5	Asociacioni Alumni	21
9.	Hulumtimi.....	21
9.1	Instituti hulumtues “Maks van der Shtul”	23
10.	Marrëdhëniet ndërkombëtare	24
11.	Ndërmarrësia dhe zhvillimi.....	25
12.	Financimi	27
13.	Mjedisi dhe shërbimet në kampus	28

13.1 Mbështetja studentore	28
13.2 Ngrehinat dhe kapacitetet teknike	29
13.3 Kampusi i UEJL-së në Shkup	29
13.4 Burimet njerëzore	30
13.5 Sistemet e informacionit	32
13.6 Shërbimet e bibliotekës	32
13.7 Parlamenti dhe Asociacioni Studentor	33
13.8 Sporti dhe rekreacioni	34
14. Konkluzionet dhe rekomandimet	34
15. Mirënjohe	36

1. Hyrje dhe konteksti institucional

Ky raport e përfshinë periudhën kohore nga 1 shtatori 2018, deri më 31 gusht 2019, por me të dhëna shtesë deri në 24 dhjetor 2019. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti e ka shënuar përvjetorin e shtatëmbëdhjetë.

(Shënim: Gjatë periudhës së këtij raporti, emri i shtetit në të cilin ndodhet UEJL-ja ndryshoi nga 'Republika e Maqedonisë' në 'Republika e Maqedonisë së Veriut'. Për qëllime të qartësisë, emri i fundit, do të përdoret ekskluzivisht në këtë raport edhe në mënyrë anakronike).

Universiteti i Evropës Juglindore ofron studime të arsimit të lartë në të tre ciklet e studimit, gjegjësisht studime deridiplomike, të magjistraturës dhe doktoratës. Ai operon në dy kampuse, të dy në Republikën e Maqedonisë së Veriut: kampusi kryesor në Tetovë dhe një kampus më të vogël në kryeqytetin e RMV-së në Shkup. Universiteti ka pesë fakultete përbërëse: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore; Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore; Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; dhe Fakulteti i Drejtësisë. Të pesë fakultetet janë të angazhuar për mësimdhënie në klasë, si dhe platformën e mësimnxënies online (*Google Classroom*). Universiteti gjithashtu ka dy qendra, (Qendrën e Gjuhëve, ku ofrohet mësimdhënie e gjuhëve të formatit arsimor pa diplomë) dhe Qendrën e-Learning, e cila ofron mësimdhënie dhe ndihmë për teknologjitë kompjuterike). Në kuadër të UEJL-së, gjithashtu, funksionon edhe Instituti për Hulumtime Shkencore 'Maks van der Shtul', i cili është vendi kryesor i veprimtarive hulumtuese bashkëpunuese për institucionin. UEJL-ja, gjithashtu, ka edhe Parkun Teknologjik, i cili siguron ndërveprim bashkëpunues midis botës akademike dhe sipërmarrëse përmes inkubacionit të biznesit dhe zhvillimit të *start-up* kompanive. Parku Teknologjik ndodhet në kampusin e Tetovës.

Universiteti paraqet rast unik në rajon për ruajtjen e politikës së përdorimit 'fleksibël të gjuhëve', duke i mbështetur tre gjuhët zyrtare që përdoren në nivel të tij: shqip, maqedonisht dhe anglisht. I gjithë komunikimi zyrtar zhvillohet në këto tre gjuhë, stafit dhe studentëve u lejohe të përdorin cilëndo prej tyre në komunikimin zyrtar brenda komunitetit të Universitetit. Për më tepër, UEJL –ja fuqimisht angazhohet për ta ofruar arsimin në dispozicion, në bazë të meritave dhe aftësive, pa marrë parasysh gjininë, gjuhën amtare, fenë, kombësinë ose përkatësinë politike të studentit. Universiteti investon shuma të konsiderueshme parash për të ofruar bursa për maturantët me sukses më të mirë nga shkollat e mesme (merret parasysh nota mesatare në shkollën e mesme), në mënyrë që të tërheq studentët më premtues, pavarësisht nga rrethanat e tyre financiare. Universiteti, gjithashtu, gëzon status juridik që nuk e ka asnjë universitet tjetër në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke u njohur zyrtarisht si një institucion 'privat-publik-jo-fitimprurës'.

UEJL-i ofron infrastrukturë të gjerë për të ndihmuar studentët në çdo fazë të karrierës së tyre akademike. Që nga momenti i aplikimit, Zyra e Shërbimeve Studentore siguron ndihmë dhe udhëzim, edhe pasi studentët të jenë regjistruar. Çdo fakultet ka nga një këshilltar studentor specifik, i cili ka për detyrë të ndihmojë studentët dhe zgjidhjen e vështirësive të tyre (gjithashtu një këshilltar studentor specifik është angazhuar për kampusin e Shkupit). Stafi akademik është i obliguar të ofrojë katër orë këshillimi në javë dhe për këtë arsye të jetë në dispozicion për ndihmë për studentët ose kërkesat e tyre. Parlamenti Studentor i përfaqëson studentët në një kuptim zyrtar dhe atyre u lejohe të kandidojnë vetë për poste përfaqësuese. Biblioteka është e hapur çdo ditë të javës, përveç të dielës, kurse stafi i saj është i trajnuar për të ndihmuar studentët në identifikimin dhe gjetjen e materialeve që kërkojnë në funksion të studimeve të tyre. Qendra e Karrierës ofron ndihmë gjatë gjithë ciklit jetësor të studentëve, duke i ndihmuar ata për marrjen e praktikës, sigurimin e trajnimeve dhe këshilla për kërkimin e punës dhe këshillimin e studentëve se si të aplikojnë me sukses për punë.

Universitetit të Evropës Juglindore i kërkohet të zbatojë Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i cili e detyron akreditimin e kurrikulave akademike (programet studimore) dhe akreditimin e mentorëve akademikë (për studentët në studimet pasdiplomike). Brenda këtyre parametrave të gjerë, Universiteti kryesisht është autonom. Drejtohet nga Rektori i zgjedhur, i cili i raporton Bordit të Universitetit; nën Rektorin është një ekip menaxhues, që e përbëjnë Këshillin e Rektorit. Senati i Universitetit është organi kryesor kolektiv i vendimmarrësve në Universitet, megjithëse shumë vendime të rëndësishme burojnë nga këshillat mësimorë-shkencorë të fakulteteve individuale.

Universiteti ka zhvillime të shumta pozitive, të përshkruara në këtë raport, megjithatë duhet të pranohet se institucioni ende përballet me një mjedis arsimor sfidues. Republika e Maqedonisë së Veriut tregon rënie të vazhdueshme demografike, duke rezultuar në më pak kandidatë për t'u rekrutuar si studentë të rinj; ky trend përkeqësohet nga emigrimi i vazhdueshëm nga vendi. Mbeten konkurrentë të shumtë institucionalë, si në formën e universiteteve shtetërore ashtu edhe kolegjeve private. Universiteti shënon një rritje të stabilitetit financiar në krahasim me vitet e fundit, por ende varet në mënyrë alarmante nga të ardhurat që janë përtej kontrollit të tij absolut, me pjesën më të madhe të të ardhurave të tij operative që rrjedhin nga pagesa e shkollimit të studentëve dhe subvencionet qeveritare.

Pavarësisht nga sfidat me të cilat UEJL-i aktualisht përballet, ato janë me të vërtetë më pak të frikshme se ato që e shoqëruan themelimin e Universitetit në vitin 2001. Në atë kohë, përmes bujarisë së institucioneve dhe kombeve donatore, si dhe përmes vizionit të udhëheqësve tanë themelues — në veçanti Maks van der Shtulit (institucion i themeluar mes vështirësive të shumta), është shndërruar në një institucion pluralist, multikulturor, shumëgjuhësor që ofron arsimim të lartë, i cili vlerësohet lart në të gjithë Ballkanin dhe diplomat e dhëna janë të njohura në të gjithë botën.

2. Raporti i Vetëvlerësimit dhe Procesi

Ky raport është rezultat i një ekipi të stafit akademik dhe administrativ të punësuar në Universitetin e Evropës Juglindore. Ata u emëruan me vendim të Drejtorisë e Rektoriale, e cila e riafirmoi një vendim të marrë vitin e kaluar akademik për emërimin e këtyre individëve specifik në Komisionin e Vetëvlerësimit.

Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit:

- Dr. Andrew Goodspeed – kryetar;
- Dr. Xhevair Memedi – zëvendëskryetar;
- Dr. Vladimir Radevski – anëtar;
- Dr. Veronika Kareva – anëtar;
- Dr. Adrian Besimi – anëtar;
- Dr. Gadaf Rexhepi anëtar;
- Dr. Sami Memeti – anëtar;
- Dr. Agron Rustemi – anëtar;
- Dr. Veli Kreci – anëtar;
- Ms. Donika Luma – anëtar.

Ekipi ka siguruar informacione nga i gjithë komuniteti i Universitetit edhe atë: nga zyrat administrative, vetë fakultetet dhe njësitë e ndihmëse akademike (të tilla si Qendra e Gjuhëve dhe Qendra e-Learning). Sugjerimet dhe njohuritë e secilit kontribuues nuk janë ndryshuar rrënjësisht, megjithëse disa kontribute janë modifikuar për qartësi dhe për harmonizimin narrativ të vetë raportit.

Raporti kur përfundohet, së pari i dorëzohet për miratim Senatit të Universitetit, pastaj i prezantohet Bordit Universitetit. Pas aprovimit nga Bordi, Raporti i Vetëvlerësimit konsiderohet i miratuar zyrtarisht nga Universiteti dhe më pas bëhet përkthimi nga anglishtja, publikohet në të tre gjuhët zyrtare të Universitetit, në ueb faqen e tij. Raporti është në dispozicion për lexuesit në mbarë botën për ta shqyrtuar pa pagesë apo abonim.

Procesi i vetëvlerësimit në Universitetin e Evropës Juglindore zakonisht vlerësohet si pozitiv, pasi mbledh një portret gjithëpërfshirës të institucionit që shpesh është i vështirë për t'u marrë në baza ditore. Informacioni që ai mbledh shpesh përdoret nga ekipi ekzekutiv dhe menaxhmenti i mesëm për të njoftuar lidhur me proceset e tyre të vendimmarrjes. Gjithashtu, rezulton në një portfolio të azhurnuar të të dhënave të dobishme për Universitetin, i cili mund të përdoret dhe është përdorur si një mjet i arritshëm për përpunimin e fakteve në lidhje me Universitetin për mysafirët, diplomatët ose organizatat ndërkombëtare.

Procesi, megjithatë, paraqet vështirësi për Komisionin e Vetëvlerësimit. 'Përdorimi fleksibël i gjuhëve' shpesh nënkupton që të dhënat dorëzohen në një gjuhë, të përkthyer në një tjetër, pastaj të përmbledhura në mënyrë narrative nga dikush që nuk i ka gjeneruar të dhënat fillestare. Kjo kërkon kohë dhe mund të çojë në gabime interpretimi. Së dyti, procesi i vetëvlerësimit historikisht është ndërmarrë gjithmonë gjatë kohës kur ka ligjërata, që do të thotë se paraqet një ngarkesë shtesë për zyrat dhe mësimdhënësit që tashmë janë të zënë me punën në Universitetit. Këshillohet që të merret në konsideratë përpilimi i Raportit të Vetëvlerësimit gjatë njërit prej pushimeve të zgjatura të Universitetit, qoftë gjatë pushimit dimëror në janar, ose pushimit veror në korrik/gusht. Përfundimisht, duhet të theksohet se përfshirja e studentëve në procesin e vetëvlerësimit është e pakënaqshme. Ata si grupi më i ndikuar nga pikat e forta ose të dobëta të Universitetit, rekomandohet që pjesëmarrja e tyre të jetë në përmasa më të mëdha.

Një shënim i fundit duhet të bëhet në lidhje me Raportin e Vetëvlerësimit dhe procesin e vetëvlerësimit. Ky raport përmban ngjashmëri zyrtare me raportet e mëparshme, në mënyrë që të bëhet krahasimi nga viti në vit i përshtatshëm dhe i pa komplikuar. Megjithatë, ky raport përfshin disa elemente të reja - siç është kjo pjesë "Raporti i Vetëvlerësimit dhe Procesi", i cili është shkruar — me qëllim që të akomodohen rekomandimet zyrtare për strukturën e propozuar nga Asociacioni i Universiteteve Evropiane. Në përputhje me rrethanat, ky raport përfshinë disa faktorë të rinj, veçanërisht theksi i shtuar në identifikimin zyrtar të sfidave dhe mundësive.

3. Të arriturat

Gjatë periudhës që përfshihet në këtë raport, Universiteti i Evropës Juglindore e inauguroi rektorin e tij të tretë, Akad. Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti. Ai e zëvendësoi rektorin në largim, Prof. Dr. Zamir Dika, i cili kishte shërbyer si rektor për tetë vjet. Procesi i zgjedhjeve ishte i rregullt dhe tranzicioni ishte i pakontestueshëm.

Në këtë periudhë Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut e rriti mbështetjen e saj financiare të Universitetit nga 500,000 Euro në 800,000 Euro. Kjo mbështetje i mundësoi Universitetit të zgjerojë angazhimin e tij për ofrimin e bursave për studentët që dëshirojnë të ndjekin studimet në këtë Universitet,

por për të cilët kostoja e shkollimit mund të jetë kufizuese. Universiteti është mirënjohës për bujarinë e Qeverisë në ofrimin e këtyre subvencioneve me vlerë.

UEJL-i vazhdon ta kultivojë dhe të mbajë angazhimin e fuqishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të ruajë marrëdhëniet tona me bashkësinë e donatorëve ndërkombëtarë përmes zyrave të tyre diplomatike në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjatë periudhës së këtij raporti, Universiteti kishte nderin të priste ambasadorët e Shqipërisë, Francës, Italisë, Sllovenisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe me ambasadorin në largim dhe atë në ardhje të Shteteve të Bashkuara, si dhe shumë delegatë vizitues dhe personalitete nga e gjithë bota, duke filluar nga Kina, Irani, Polonia dhe takim me përfaqësuesit lokalë dhe me qendër në Uashington të USAID-it. Gjithashtu, të sponsorizuar nga SHBA, disa studiues të Fulbright qëndruan në Universitet gjatë periudhës së këtij raporti dhe dhanë kontribute të vlefshme për të cilat institucioni është mirënjohës. Në një nivel më lokal, rektori dhe ekipi i tij drejtues ekzekutiv takuan vazhdimisht përfaqësues të top universiteteve lokale dhe rajonale për të diskutuar mundësitë për bashkëpunim. Për më tepër, Universiteti i Evropës Juglindore ka kërkuar të ndërtojë, ose të mbajë lidhje të forta me biznesin vendor dhe komunitetin sipërmarrës, me menaxherë të shquar, udhëheqës biznesi dhe filantropë që e vizitojnë institucionin.

Universiteti ndërmori rishikime të shumta të rregulloreve dhe statuteve dhe i kaloi ato në mënyrë të duhur përmes Senatit të Universitetit, për të akomoduar ndryshimet në Ligjin e rishikuar së fundmi për Arsimin e Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Rishikimi gjithashtu rezultoi në emërimin dhe instalimin e kryetarit të ri të Senatit. Kjo e gjitha ishte një përpjekje e madhe për t'i ristrukturuar udhëzimet e brendshme dhe ajo ndikoi në pjesën më të madhe të rregulloreve në lidhje me funksionimin e Universitetit, si dhe e sjell Universitetin plotësisht në përputhje me kërkesat ligjore për funksionimin e tij.

UEJL gjithashtu ndërmori një përpjekje të konsiderueshme të akreditimit dhe ri-akreditimit të programeve, duke rezultuar me zbatimin e një strukture të re të atyre programeve të studimit. Rezultat më i rëndësishëm i kësaj është transferimi i programeve studimore deridiplomike në strukturën me 240 ECTS, nga të mëparshmet me 180 ECTS. Për më tepër, UEJL ndërmori një plan të ri të titulluar "Programi i Kompletimit Akademik", i cili synon të theksojë mbështetjen institucionale, këshilla akademike dhe mundësitë e bursave, për t'i përfshirë sërish studentët joaktiv në programet e tyre studimore.

Universiteti kishte kënaqësinë të organizojë konferenca të shumta, tryeza të rumbullakëta, punëtori, ligjërata dhe grupe diskutimi gjatë periudhës së këtij raporti. Kjo është në përputhje me angazhimin tradicional të UEJL-së që t'ju mundësojë folësve të jashtëm dhe publikut një forum të drejtë dhe studimor për shprehjen e ideve të tyre në një ambient akademik dhe kolegial. Në këto përpjekje të dukshme ishin konferencat e organizuara nga UEJL, siç janë ato për "Luftimin e korrupsionit në arsimin e lartë" dhe "Fillimet e pluralizmit politik në Maqedoni." Universiteti, gjithashtu, mbajti një tryezë rajonale të dallueshme "Etika dhe Integriteti në Sistemet e Arsimit të Lartë në Ballkanin Perëndimor". UEJL, gjithashtu, kishte kënaqësinë që mundi të ofrojë "Shkollën Verore për Sipërmarrësi dhe Komunikim Ndërkombëtar", e cila mblodhi studentët nga UEJL-ja dhe Gjermania në kampusin tonë në Tetovë. Institucioni, gjithashtu, pati sukses me aplikimet në 'Horizon 2020' dhe i zgjeroi përpjekjet e tij për të paraqitur propozime dhe grante për hulumtime. Për më tepër, një bashkëpunëtor i ri hulumtues me përvojë ndërkombëtare u emërua në Institutin e Hulumtues 'Max Van der Stoel' për të shtuar kapacitetet e këtij instituti.

Arritja kryesore e Universitetit, megjithatë, nuk mbetet njohja e jashtme apo ndërkombëtare, por aktivitetet e përditshme të punës së studentëve, mësimeve, administratorëve dhe menaxhmentit të këtij institucioni akademik. Është puna e tyre e përditshme për të ndjekur dhe promovuar njohuritë e që mbetet arritja më e dukshme e UEJL-së.

4. Mundësitë

Universiteti i Evropës Juglindore është institucion rajonal i dalluar i arsimit të lartë, në të cilin misioni kryesor është sigurimi i studimeve të ekselencës, ndërkombëtarisht konkurruese për studentët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, kombësia, gjuha amtare, feja ose përkatësia politike. UEJL ka histori të dëshmuar të angazhimit ndërkombëtar dhe partneritetit ndërkombëtar. Këta faktorë e bëjnë atë partner të vlefshëm - dhe partner i së ardhmes - në rajon për universitetet dhe institucionet tjera hulumtuese jashtë vendit, për agjencitë ndërkombëtare humanitare ose agjencitë e zhvillimit, si dhe për ambasadat dhe konsullatat. UEJL i ndjekë mundësitë e tilla dhe synon ta bëjë këtë. Pikëpamja e përgjithshme e Universitetit është se e ardhmja e arsimit të lartë është bashkëpunimi.

Universiteti ka dy nga kampuset më tërheqëse dhe mikpritëse në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke e bërë atë një vend të dëshirueshëm për të studiuar dhe për të ligjruar. Teknologjia e përdorur në të dy kampuset është e përditësuar dhe në baza të rregullta monitorohet, rregullohet dhe përmirësohet nga stafi i përkushtuar i departamentit të TI-së. Këto janë asetë që duhet të promovohen dhe të mirëmbahen, pasi ato mund të ofrojnë mundësi vendimtare për regjistrimin dhe kalueshmërinë e studentëve.

Universiteti, gjithashtu, vazhdon të mirëmbajë modelin e sigurimit të cilësisë, i cili është i ngulitur thellë në kulturën e institucionit. Disa masa domethënëse për të garantuar cilësinë që UEJL e aplikon rregullisht janë: procesi i vëzhgimit të mësimdhënies (vlerësimi i kolegëve nga kolegët gjatë një ore mësimore); procesi i vlerësimit nga studentët (anketime anonime të studentëve në lidhje me orët mësimore dhe profesorët e tyre); procesi i vlerësimit të stafit (me të cilin çdo mësimdhënës ka një vlerësim personal, të thelluar nga menaxheri i tij/saj); dhe modeli i trajnimit të stafit (me të cilin të gjithë stafi ka grupe trajnimi dhe diskutimi për gjashtë ditë në vitin akademik, 3 ditë në gusht dhe 3 në shkurt). Këto — të kombinuara me proceset e tjera të Universitetit, siç është udhëzimi i hulumtimit i dhënë nga Komiteti Qendror i Hulumtimit - ndihmojnë për të siguruar që UEJL arrijë dhe mirëmbajë, përsosmërinë akademike në mësimdhënie dhe në komunitetin e hulumtimit.

Qendra e Biznesit dhe Inovacionit, si dhe Parku Teknologjik i UEJL-së paraqesin angazhimin e vazhdueshëm të Universitetit për t'u angazhuar me botën e korporatave dhe sipërmarrësve.

fokus i periudhës së mbuluar nga ky raport për të Zgjerimi i bashkëpunimit ekzistues me drejtuesit e biznesit në rajon dhe krijimi i kontakteve të reja me kompanitë, menaxherët dhe korporatat të cilët po udhëheqin përpjekjet financiare dhe sipërmarrëse të Ballkanit Perëndimor, ishte njëri nga fokuset kryesore në periudhën që mbulon ky raport. Qendra e Biznesit dhe Inovacionit, si dhe Parku Teknologjik kanë bërë përpjekje për ta ruajtur dhe thelluar atë bashkëpunim midis akademisë dhe ndërmarrjeve.

Kostoja e shkollimit në UEJL është dukshëm më e ulët se ajo e universiteteve të Evropës Perëndimore ose Amerikës së Veriut; kjo mund të jetë një mundësi se ka një treg të konsiderueshëm për rekrutimin në mesin e komuniteteve të diasporës shqiptare dhe maqedonase.

Gjithashtu, duhet të theksohet se UEJL e ka provuar veten të jetë i adaptueshëm në zhvillimin e tendencave në arsim, sigurimin e cilësisë, rekrutimin e studentëve dhe shërbimet, si dhe mjedisin përgjithësisht evoluues për universitetet si në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ashtu edhe në rajon. Kjo aftësi institucionale për të qëndruar të kujdesshëm ndaj tendencave të ndryshimit, duke mbajtur një angazhim të fortë për misionin dhe parimet arsimore të Universitetit, tregon se UEJL-ja ka krijuar një kulturë institucionale që mund t'i rezistojë sfidave të dukshme të rëndësishme me të cilat përballen të gjitha universitetet në Ballkanin Perëndimor.

5. Sfidat

Tregu i arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut mbetet mjaft konkurrues, me universitete të shumta shtetërore dhe kolegje të shumta private që konkurrojnë për secilin student. Kjo, kur kombinohet me numrin e popullsinë në rënie (për shkak të rënies demografike dhe emigracionit), do të thotë që rekrutimi i studentëve dhe mbajtja e tyre mbetet një përparësi kritike e UEJL-së. Universiteti është shumë i varur nga të ardhurat operative nga shkollimi i paguar nga studentët, kështu që çdo ulje në numrat e regjistrimit ose të kalueshmërisë ka një ndikim të drejtpërdrejtë në aftësinë e Universitetit për të ndjekur standardet më të larta të arsimit dhe arritjeve.

Një sfidë tjetër domethënëse e shtruar nga numri i shumtë i institucioneve të arsimit të lartë që konkurrojnë në rajonin e Ballkanit është se përpjekjet për të tërhequr partneritete hulumtuese, marrëveshje bilaterale institucionale, ose financim të projekteve janë shumë konkurruese. Edhe pse UEJL-i mbetet i përkushtuar në një konkurrencë të tillë të hapur dhe kërkon të fuqizohet, duhet të theksohet se grantet dhe projektet kryesore po bëhen gjithnjë e më të vështira për t'u fituar, pikërisht për shkak të kësaj konkurrence. Në këtë fushë, gjithashtu, duhet ta kemi parasysh se fokusi kryesor i UEJL-së në shkencat shoqërore, studimet juridike, gjuhët dhe biznes në masë të madhe e kufizon Universitetin të aplikojë për disa nga mundësitë më fitimprurëse të hulumtimit, shumë prej të cilave kërkojnë laboratorë fizikë të gjerë.

Kampusi kryesor në Tetovë ka filluar të tregojë shenja të amortizimit të objektit dhe pajisjeve, duke kërkuar shpenzime shtesë thjesht për të zëvendësuar, ose rregulluar materialet e nevojshme. Konviktet, klasat, zyrat administrative dhe infrastruktura e përgjithshme kërkojnë përmirësime periodike të pajisjeve dhe mbeten të shtrenjta për t'u ngrohur në dimër dhe të kushtueshme për t'u ftohur në verë. Pritjet e vjetrit teknik dhe degradimi i përgjithshëm i materialeve me kalimin e kohës, paraqesin kosto shtesë që Universiteti ka të ngjarë t'i has në të ardhmen në afat të shkurtër-mesëm.

Universiteti asnjëherë nuk ka qenë i kënaqur me nivelin e diplomimit në kohë. Edhe pse studentët që diplomohen dëshmojnë se kanë nivele të larta punësimi rajonalisht, por është shqetësim që shumë studentë ose i braktisin plotësisht studimet (duke mos arritur të përfundojnë studimet e tyre), ose nuk diplomojnë me kohë (d.m.th., duke marrë më shumë kohë se sa koha e pritur për të përfunduar studimet). Kjo duhet të jetë një element shqetësues për të gjithë komunitetin e Universitetit dhe duhet të bëhen përpjekje në të dy nivelet makro dhe mikro për të zbuluar, ndërhyrë dhe parandaluar që studentët të tërhiqen, ose të vonojnë përfundimin e programit të tyre.

Mungesa e një Asociacioni Alumni të efektshëm e privon Universitetin nga një komponent i pazëvendësueshëm i komunitetit të UEJL-së, i cili mund të ndihmojë në çështje të tilla si: qasje sociale, këshilla kurrikulare, praktikë dhe asistencë për punësim dhe mundësi të vlefshme për rrjetëzimin e biznesit. Duhet të jetë një përparësi e lartë e Universitetit për ta rigjeneruar Asociacionin Alumni, pasi alumni përfaqëson një nga pasuritë më të vlefshme mbi të cilat një universitet mund të kërkojë këshilla, zhvillim dhe promovim.

Stafi akademik i UEJL-së mbetet profesionist, i përkushtuar dhe me kualifikim të lartë, por sfidat vazhdojnë në sferën akademike. Zakonisht është një ankesë e studentëve që lëndët duken më të dizajnuara për të përmbushur interesat dhe ekspertizën e mësimdhënësve sesa nevojat e sakta të studentëve. Gjatë anketimit të studentëve, gjithashtu, vërejnë se materiali nganjëherë duket i dyfishuar midis cikleve të studimit (d.m.th, i njëjti material i paraqitur në një lëndë në ciklin e parë rishfaqet në një lëndë të ngjashme në ciklin e dytë). Promovimi i stafit akademik në thirrje mësimore-shkencore mbetet i krahasuar me arritjet e dëshmuara si studiues, mësimdhënës dhe si kontribuues në komunitet, megjithatë është efektive automatike. Stafi akademik ka pranuar sfidën për të kërkuar konferenca dhe revista më serioze dhe rigorozë përzgjedhëse të disponueshme për të publikuar punën e tyre hulumtuese, por

ndodhin botime të dobëta herë pas here ose "konferenca pushimesh". Së fundmi, Universiteti është në kundërshtim me tendencat bashkëkohore arsimore për të pasur kaq pak staf ndërkombëtar me kohë të plotë. Për ta adresuar këtë, UEJL ka dhënë përparësi në marrjen në punë të stafit ndërkombëtar, ose përdorimin e mobilitetit të stafit dhe programeve të granteve, për të rritur praninë e stafit mësimor ndërkombëtar në vitin akademik 2020-2021.

Më në fund, duhet të theksohet se pranimi i aplikantëve në programe, në ciklin e parë dhe të dytë është për të gjitha qëllimet praktike, automatik. Në thelb nuk ka procese refuzimi për aplikantët në ciklin e parë dhe të dytë (studimet e doktoratës janë të kufizuara nga kufizimi ligjor për numrin e kandidatëve që një mësues individual mund të mentorojë). Kjo, do të thotë që Universiteti pranon disa studentë që mbase pa asnjë faj të tyre, janë sidoqoftë të papërgatitur ose të padenjë për arsimin terciar. Rekomandohet që standardet minimale themelore për aplikantët të konsiderohen për të pasqyruar prioritetet e proceseve të përzgjedhjes së mirë.

6. Struktura: fakultetet dhe qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore operon me dy kampuse universitare në Tetovë dhe në Shkup. Oferta akademike sigurohet nga pesë fakultetet përbërëse të tij,

- Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë;
- Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore;
- Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore;
- Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; dhe
- Fakulteti i Drejtësisë.

Studentët i ndjekin lëndët mësimore që i zgjedhin, të cilat kryesisht përbëhen nga lëndët e obligueshme (ose 'thelbësore') të mbajtura në fakultetin e tyre. Ekzistojnë gjithashtu lëndë 'zgjedhore' të disponueshme brenda programit të përzgjedhur, në mënyrë që studentit t'i mundësohet personalizimi i arsimit të tij/saj në përputhje me interesat e tij/saj specifikë, ose dëshirat e specializimit të punës. Në fund të fundit, ekzistojnë lëndë 'zgjedhore të lira', të cilat janë lëndë të përgjithshme të shërbimeve që u japin mundësi studentëve të studiojnë lëndë, bazuar në interes, jashtë fakultetit të tyre specifik. Prandaj, studentëve shumica e lëndëve u ofrohet në kuadër fakultetit të tyre të zgjedhur.

Brenda Fakultetit studenti ka qasje tek këshilltari studentor, puna kryesore e të cilit është të ndihmojë studentët me këshilla, ose të zgjidhë vështirësitë. Për më tepër, administratori i fakultetit shpesh ofron shërbime të lidhura me studentët në detyra administrative. Çdo mësues individual është tutor i një grupi prej 4-7 studentëve në studimet deridiplomike, për të siguruar ndihmë të përgjithshme akademike dhe për t'i identifikuar problemet e mundshme në përmbushjen e kërkesave të programit të studentit.

6.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë është fakulteti më i madh në Universitet, si për nga numri i studentëve të regjistruar ashtu edhe për nga numri i stafit. Ofron studime në të tre ciklet, të shpërndara si më poshtë: programe deridiplomike në Biznes dhe Ekonomi (me module në Ekonomi; Ndërmarrësi; Financa dhe Kontabilitet, Financa dhe Banka, Menaxhment dhe Marketing); programe të magjistraturës në Administrim Biznesi, Financa, Financa dhe Kontabilitet, Menaxhment, Marketing, Logjistikë

Profesionale dhe Menaxhim i Zinxhirit të Furnizimit dhe Menaxhim Profesional i Shitjeve; dhe programe të doktoratës në Administrim Biznesi dhe Ekonomi.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, stafi i Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë mori pjesë në konferenca të shumta ndërkombëtare, në vende si: Kroacia, Rumania, Turqia dhe Mbretëria e Bashkuar; Fakulteti gjithashtu ka mbajtur konferencën e titulluar 'Nga tranzicioni në zhvillim: Sfidat dhe perspektivat e reja.' Fakulteti i B&E, gjithashtu, ka gjeneruar seminare dhe punëtori të shumta, të tilla si tryeza e rrumbullakët e studentëve, grupi i diskutimit i absolventëve për 'tejkalimin e mospërputhjes me tregun të punës' dhe Shkolla Verore FBE me temën "Mendimi kritik në epokën digjitale". Në një shënim të ngjashëm, FBE bashkë-organizoi (me Kolegjin "Yahya Kemal"), një seminar mbi mendimin kritik për nxënësit e shkollave të mesme.

Pjesa më e madhe e theksit të FBE-së në këtë periudhë ka qenë në forcimin e marrëdhënieve me studentët, absolventët dhe alumnin. Në përputhje me rrethanat, Fakulteti i B&E organizoi takime të rregullta me studentë aktualë, studentë të sapodiplomuar, absolventët dhe alumnin. Fakulteti, gjithashtu, ka një rol udhëheqës në bashkëpunimet e Universitetit me komunitetin e biznesit dhe sipërmarrës, duke pasur parasysh afërsinë e interesave të botës së korporatave dhe lëndës hulumtuese të fakultetit.

6.2 Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore ofron studime në të tre ciklet e studimit, me programet studimore deriplomike: Informatika e Biznesit, Inxhinieria Kompjuterike dhe Shkencat e Kompjuterike; programet studimore të magjistraturës në Informatikën e Biznesit, Shkencat e Kompjuterike (me aplikacione për modul në Zhvillim të Softuerit dhe Aplikacioneve, Inxhinierinë e të Dhënave, Sistemet Ueb dhe Mobile, Inxhinieri Softuerike dhe Sistemet e Informacionit) dhe Zbatimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit në Mësimdhënie; dhe studime të doktoratës në Shkencat Kompjuterike.

SHTB vazhdon të gëzojë një nga nivelet më të larta të punësimit të studentëve të diplomuar të UEJL-së, duke treguar njohjen e vazhdueshme të tregut ndaj cilësisë dhe modernitetit të kurrikulave të SHTB-së. Megjithatë, fakulteti vazhdon të përballet me sfida të vështira në rekrutimin e studentëve në programet pasuniversitare, duke e pasur parasysh eksportueshmërinë e lartë të shkathtësive të shkencave kompjuterike. Sidoqoftë, gjatë periudhës së këtij rishikimi, fakulteti ka mbajtur një grup të qëndrueshëm, të pa fragmentuar të studentëve në studimet deriplomike, në të dy kampuset, në atë të Tetovës dhe Shkupit. Duke lënë mënjanë FINKI-in (UKIM), të dhënat e regjistrimit tregojnë tregun fitues për SHTB-në në të dy nivelet e studimit deriplomike dhe ato pasuniversitare në krahasim me universitetet e mëdha shtetërore, UNT-në (Nënë Tereza) dhe USHT-në (Universiteti Shtetëror i Tetovës). Studimet në gjuhën angleze në studimet deriplomike po përballen me një rritje, gjithsej 42 studentë në të dy kampuset i ndjekin lëndët plotësisht në gjuhën angleze.

Jashtë klasave dhe laboratorëve, përpjekjet kryesore të Fakultetit të SHTB-së në periudhën e këtij raporti kanë qenë 1) ndërtimi i marrëdhënieve më të forta me biznesin vendor dhe ndërkombëtar, si dhe komunitetet sipërmarrëse, dhe 2) rritjen e profilit ndërkombëtar të programeve të SHTB-së, mësimdhënësve, studentëve dhe aluminit. Në mbështetje të këtyre qëllimeve, SHTB ka punuar në bashkëpunim me Parkun Teknologjik të UEJL-së për të siguruar mundësi për punë praktikë për studentët. SHTB ka përfshirë 3-4 anëtarë të stafit ndërkombëtar për të dhënë mësim, kryesisht në studimet e magjistraturës me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes ndërkombëtare të anëtarëve të stafit në procesin mësimor. SHTB ka aplikuar në disa dhe ka fituar tre projekte të mëdha hulumtuese, dy nga skema e financimit Erasmus + dhe një nga Horizon2020, i cili është i pari i këtij lloji për UEJL-në.

6.3 Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore është përqendruar kryesisht tek ata që dëshirojnë të bëjnë karrierë në sektorin publik, megjithëse SHSHB-ja parashikon që studentët të përfshihen në mundësi të shumta brenda apo jashtë shërbimeve qeveritare. Ofron studime në të tre ciklet e studimit, të shpërndara si në vijim: programet studimore deridiplomike në Menaxhim Publik dhe Administrata (me module në Menaxhimin e Organizatave Joqeveritare dhe Menaxhimin Publik dhe Politikë), Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare (me module në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare), si dhe Punë dhe Politikë Sociale; programet studimore të magjistraturës në Diplomaci, Qeverisje, Administrim Publik, Shkenca Politike dhe Studime Evropiane (program i përbashkët me Universitetin e Lubjanës); dhe studime të doktoratës në Shkenca Politike dhe Qeverisje Publike dhe Administrata.

Përpjekjet kryesore të vetë-rregullimit të SHSHB-së në periudhën e mbuluar nga ky raport përfshijnë riakreditimin e kurrikulave të bazuara në raporte të jashtme dhe sugjerime të dhëna nga studentët dhe stafi, një proces që përfshin akreditimin e programit E-Qeverisja program i magjistraturës. Për më tepër, lëndët kryesore të në studimet e magjistraturës u rishikuan në dritën e ushtrimeve të hartimit të kurrikulave. Nga jashtë, SHSHB ishte i kënaqur të vërejë një rritje të studentëve dhe stafit që marrin pjesë në programet e lëvizshmërisë Erasmus dhe Fakulteti organizoi ose bashkëorganizoi dy konferenca akademike ndërkombëtare me pjesëmarrje të konsiderueshme nga jashtë.

Fakulteti i SHSHB-së, gjithashtu, inicioi një politikë të monitorimit të niveleve të kalueshmërisë së studentëve dhe vendosi një prag suksesi për të shërbyer si një fakultet standard i përparimit të studentëve. Përveç kësaj, fakulteti bëri një përpjekje të përbashkët për të identifikuar dhe riaktivizuar studentët e magjistraturës, të cilët kishin rënë në "pasivitet", për t'u përpjekur t'i kthejnë ata në komunitetin akademik. SHSHB-ja, gjithashtu filloi krijimin e një rrjeti lokal të punëdhënësve si bashkëpunëtorë, veçanërisht për të kërkuar këshilla për kurrikulat dhe krijimin e lidhjeve të mundshme të punësimit për studentët e diplomuar. Më në fund, Fakulteti ka ndërmarrë një iniciativë për qasje të komunitetit, një përpjekje e konsiderueshme të periudhës së mbuluar nga ky raport, veçanërisht në drejtim të pjesëmarrjes në debate lokale dhe të transmetuara, si dhe tryezave të rrumbullakëta dhe rritjes së përdorimit të mediave sociale nga stafi i fakultetit në lidhje me rekrutimin e studentëve.

6.4 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ka një strukturë unike të departamenteve, duke u ndarë në Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane dhe Departamentin e Komunikimeve Ndërkombëtare. Me përjashtim të Komunikimeve Ndërkombëtare (e cila përqendrohet në teorinë e komunikimit, marrëdhëniet me publikun, diplomacinë, negocimin, semiotikën, etj.). Këto departamente ofrojnë udhëzime gjuhësore për studentët që kryesisht synojnë të bëhen mësues të gjuhës, përkthyes ose interpretues, ose ata që ndryshe mund të kërkojnë aftësi të përparuara gjuhësore (në fushat e korporatave ose hotelarisë). Dallon nga Qendra e Gjuhëve e UEJL-së (nga më poshtë), me atë që në Qendrën e Gjuhëve ofrohet mësimdhënie e gjuhëve të formatit arsimor pa-diplomë për ata që specializohen në lëmi tjera nga gjuhët; kurse në departamentet e gjuhës shqipe, angleze dhe gjermane ligjërohet për ata që kërkojnë kualifikim me diplomë në ato disiplina specifike gjuhësore.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, GJKK organizoi tryeza të rrumbullakëta dhe mikro-konferenca, si dhe angazhime në shumë aktivitete promovuese jashtë Universitetit. Stafi akademik ka marrë pjesë në konferenca të jashtme akademike në të gjithë Evropën dhe (në disa raste) përtej Evropës dhe kanë botuar gjerësisht në revista akademike të recensuara nga kolegët. Programet akademike mbetën

popullore, me sukses të konsiderueshëm në regjistrimin e studentëve në programin e magjistraturës— Mësimdhënia e Gjuhës Angleze — megjithatë duhet të theksohet se në programin deridiplomik-Gjuhë dhe Letërsi Angleze regjistrimi mbetet shqetësim anemik dhe programi-Gjuhë dhe Letërsi Shqipe vazhdon të mbetet “i tronditur” për të mirë. Shpresohet që rishikimi i plotë i kurrikulës nga viti i kaluar, do të adresojë disa nga këto mangësi.

Fakulteti beson se duhet të vazhdojë të rishikojë kurrikulat për të përmbushur nevojat bashkëkohore gjuhësore, duke theksuar funksionalitetin dhe përdorimin mbi gramatikën e memorizuar tradicionale. Ky ridizajnim kurrikular, do të bëhet në baza gjithëpërfshirëse, në mënyrë që të kërkojë kontributet dhe idetë e të gjithë stafit akademik. Megjithatë, duhet të theksohet se ka pasur pak ose aspak planifikim për stafin afatgjatë të Fakultetit, që do të thotë se planifikimi kurrikular mund të ndikojë gjithashtu në nevojat për specializim të stafit.

6.5 Fakulteti i Drejtësisë

Fakulteti i Drejtësisë ofron studime në dy fusha kryesore në programet e studimeve deridiplomike – Studime të Drejtësisë; dhe Kriminalistikë e Siguri, ndërsa i zgjeron ato në ofertat në ciklet pasuniversitare, duke përfshirë Të Drejtën Civile, Të Drejtën Penale, Të Drejtën Kushtetuese, Krimin Kompjuterik, Të Drejtën Ndërkombëtare dhe Studime të Sigurisë. Në vitin akademik 2018/19, Fakulteti i Drejtësisë, në bashkëpunim me Zyrën e Planifikimit Akademik, përfunduan me sukses procesin e akreditimit të dy programeve studimore shumë të rëndësishme: Studime të Drejtësisë/moduli: Studime të Drejtësisë (240 ECTS) dhe Studime të Drejtësisë/modul: Informatikë Juridike (240 ECTS), si një program unik në rajon.

Në periudhën që përfshinë ky raport, si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm Fakulteti i Drejtësisë për mësimin praktik dhe të aplikuar, ka angazhuar gjyqtarë, avokatë, ekspertë të mjekësisë ligjore, prokurorë, noterë dhe përfaqësues të komunave për t'ju drejtuar studentëve. Shumë nga këta ekspertë kanë ndihmuar gjithashtu që të përshtaten plotësisht me kërkesat ligjore për mësimdhënien ‘klinike’ (mësimdhënie nga ekspertë të jashtëm të arritjeve të verifikuara), duke siguruar trajnime praktike për studentët. Për më tepër, Fakulteti priti pedagogë vizitues nga jashtë, përfshirë mysafirë nga Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës (përmes programit Fulbright). Një nga zhvillimet më domethënëse gjatë kësaj periudhe ishte në semestrin veror 2019 — me mbështetjen e Ambasadës Amerikane — Fakulteti hapi dhe operon me Klinikën Ligjore të UEJL-së.

Ngjarje të dukshme për këtë periudhë përfshijnë: Konferencën e Tretë Vjetore të Studentëve të Drejtësisë (këtë vit me temën 'Juristët e rinj dhe e ardhmja e drejtësisë'), Konferencën e parë (të organizuar në bashkëpunim me fakultetin SHSHB-së) me temë 'Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit dhe perspektiva e integritetit në BE ', dhe një Debat publik në bashkëpunim me shoqatën për edukimin dhe hulumtimin e kërkimit e shëndetit mbi temën e abortit. Fakulteti i Drejtësisë, gjithashtu është angazhuar në aktivitete të shumta në terren, konkretisht në drejtim të takimit dhe bashkëpunimit me alumnin dhe në rekrutimin e synuar të studentëve.

6.6 Qendra e Gjuhëve

Qëllimi dhe misioni i Qendrës së Gjuhëve (QGJ), është të sigurojë mësimdhënie cilësore dhe mbështetje në kontekst të të mësuarit të gjuhëve të huaja për të gjithë studentët e ciklit të parë studimor, me përjashtim të atyre që studiojnë për gjuhë në FGJKK. Mësimdhënia e gjuhëve në QGJ është e standardizuar sipas CEFR (Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencave), për lëndët e gjuhës shqipe, angleze dhe maqedonase (gjuhët lokale të destinuara veçanërisht për folësit vendas të gjuhës "tjetër" lokale).

Në periudhën e përshtirë nga kjo përmbledhje, disa nga zhvillimet kryesore për Qendrën e Gjuhëve kishin të bëjnë me përfshirjen e aftësive profesionale dhe aftësive 'praktike – të përditshme' (qëndrimi profesional, komunikimi profesional, me shkrim dhe të folur, prezantimi, etj.) në kurset e anglishtes për qëllime specifike (ESP): Anglisht për Teknologji Informatike, Anglisht për Biznes, Anglisht për Shkencat Sociale dhe Anglisht për Juristët. Programet mësimore për këto kurse u modifikuan për të përfshirë materiale të azhurnuara, përmbajtje më profesionale dhe përdorim të specializuar të gjuhës. U zgjedhën libra dhe/ose materiale të reja për kurset e ESP, duke theksuar që mbështetja e tepërt vetëm në libra duhet të reduktohet, pasi ato mund të jenë të vjetruara, të dizajnuara për një grup specifik njerëzish ose thjesht jo mjaftueshëm tërheqës. Prandaj, u ndërmorën aktivitete për përpilimin ose adaptimin e materialeve dhe skripteve, së bashku me detyrat që korrespondojnë me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara të lëndëve.

Stafi i Qendrës së Gjuhëve gjithashtu kontribuoi në përzgjedhjen dhe adaptimin e një testi të ri për përcaktimin e nivelit të njohurive të studentëve të rinj, të siguruar nga shtëpia botuese MM, e që u dëshmuar të jetë më i saktë në vendosjen e studentëve në nivelet përkatëse. Fulbright mysafirja e QGJ-së, znj. Sophie Aroesty na ndihmoi në krijimin e dy klubeve në QGJ, si dhe ligjëroi në grupe të ndryshme, duke përdorur aktivitete praktike kryesisht të përqendruara në aftësitë e punësimit. Për më tepër, QGJ-ja organizoi një punëtori shumë të suksesshme "Inovacionet në mësimdhënien e gjuhës angleze", në të cilën morën pjesë 200 pjesëmarrës dhe 5 folës ndërkombëtarë. Qendra, gjithashtu, u angazhua në shënimin e Javës së Gjuhës Italiane, në konkursin rajonal dhe kombëtar të drejtshkrimit "Spelling Bee", në projektin "Le të bisedojmë" me vullnetarët e Korpusit të Paqes dhe në "Javën e filmit".

Sfidat kryesore me të cilat përballet QGJ-ja kanë të bëjnë me planifikimin kufizues të orëve (08:00-10:00 dhe 14:00-16:00), në dispozicion për orët në këtë qendër, pasi paraqet ngarkesë/lozhje dhe vështirësi logjistike për personelin dhe për QGJ-në në përgjithësi. Një zhvillim tjetër për të cilin ka nevojë Qendra e Gjuhëve është mundësia për t'u shndërruar në një qendër të certifikuar testimi për gjuhët që ofron dhe do të punojmë në këtë drejtim në të ardhmen e afërt.

6.7 Qendra E-Learning

Qendra E-Learning filloi të funksionojë që nga hapja e Universitetit nga shtatori i vitit 2001, për të ndihmuar bashkësinë e universitetit, si studentët ashtu edhe mësimdhënësit, duke e shfrytëzuar potencialin e teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Qendra ofron kushte të shkëlqyera për përfshirjen e E-Learning për të mbështetur studentët gjatë studimeve. Qendra E-Learning u ofron qasje studentëve në katër laboratorë kompjuterikë, me mbi 80 kompjuterë modern dhe një laborator multimedial të pajisur me teknologjitë më të fundit. Përveç kësaj, Qendra u ofron studentëve lëndë të lira zgjedhore në softuerin e zyrës së Microsoft (Word, Excel, PowerPoint dhe më shumë).

Qendra gjithashtu ndihmon komunitetin e Universitetit në shfrytëzimin e potencialit të teknologjisë për të përmirësuar mësimdhënien dhe të mësuarit. Ajo siguron mbështetje për zhvillimin e materialeve ndërvepruese dhe plotësuese online për kurset tradicionale dhe organizon punëtori trajnimit në lidhje me zhvillimin dhe shpërndarjen e materialeve online. Qendra siguron mbështetje për stafin për përdorimin *Google Classroom*, lejon mësimdhënësit të krijojnë orë mësimore, të dizajnojnë detyra, të komunikojnë me studentët, t'i organizojnë dosjet, ta ndjekin punën e studentëve online dhe në mënyrë të vazhdueshme. Mësuesit dhe studentët mund ta përdorin *Google Classroom*-in me të gjitha aplikacionet e tjera të Google për të shkëmbyer menjëherë informacione me njëri-tjetrin. Për më tepër, secili student ka dosjen e tij ose të saj *Google Drive*, që i lejon mësimdhënësit dhe studentët të hyjnë në ato dosje, në

mënyrë që të gjurmojnë përparimin dhe punën e studentëve; mësimdhënësit gjithashtu mund të caktojnë nota brenda *Google Classroom*.

Shkurt, misioni i Qendrës së E-Learning është të përgatit mësimdhënësit dhe studentët, të cilët kanë njohuri dhe shkathtësi të fuqishme në e-Learning për të ofruar mësim të shkëlqyera dhe për të maksimizuar mësimnxënien e studentëve.

7. Sigurimi i Cilësisë

Sigurimi i Cilësisë (SC), ka rol kryesor në të gjitha aktivitetet e Universitetit dhe përqendrimi në cilësinë po merr vëmendje më të madhe çdo vit. Zyra e SC-së ka vazhduar me aplikimin e instrumenteve të ndryshme për matjen e cilësisë së mësimdhënies, si dhe matjen e kënaqësisë së studentëve dhe stafit. Këto instrumente përfshijnë procesin e vëzhgimit të mësimdhënies; vlerësimin online nga studentët të lëndëve akademike; vlerësimin online nga studentët të shërbimeve; si dhe anketimin e kënaqësisë së stafit. Rezultatet e mbledhura janë përdorur për t'i identifikuar mënyrat për ta përmirësuar mësimdhënien dhe të mësuarit me të gjithë përbërësit e përfshirë, siç janë, për shembull: përgatitja e planprogramit; metodologjitë për mësimdhënie "studentët në qendër"; mënyrat e sigurimit të informatave kthyesë dhe organizimit të vlerësimit; materialet e përdorura; etj., duke synuar rritjen e aftësive të studentëve për inovacion dhe sipërmarrje dhe për të rritur nivelin e përgjithshëm të punësimit të studentëve.

Zyra e SC-së e ka koordinuar përgatitjen, organizimin dhe vlerësimin e seancave të zhvillimit të stafit dy herë gjatë periudhës së këtij shqyrtimi, me informatat kthyesë të përdorura për planifikimin e ngjarjeve të tjera të ngjashme, të destinuara për të përmirësuar performancën e përgjithshme të stafit akademik dhe administrativ. Zyra gjithashtu është përgjegjëse për Procedurën për pranimin e ankesave dhe ajo ka kontribuar në arritjen e kompromisit në disa raste me studentët dhe anëtarët e stafit.

Aktivitetet e Bordeve për Bashkëpunim dhe Mirëbesim me Komunitetin (Ekipet e cilësisë së fakulteteve), janë mbështetur për të inkurajuar studentët dhe kontributin e jashtëm, si dhe përqendrimin në kompetencat profesionale dhe përparimin në karrierë. Zhvillimi i sistemit të auditimit të dyfishtë për vlerësimin e performancës është ruajtur në mënyrë aktive përmes aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me shërbimet e tjera të Universitetit. Zyra e ka koordinuar planin e zbatimit të rekomandimeve nga vlerësimi i jashtëm (IEP), duke rezultuar me një raport të favorshëm për zbatimin një vjeçar.

Sigurimi i Cilësisë në UEJL tashmë është konsoliduar mirë dhe ka arritur të krijojë një kulturë universitare cilësore që është e njohur në shoqërinë institucionale dhe në komunitetin e gjerë. Megjithatë, sfidat ekzistojnë. Disa nga proceset mund të bëhen mekanike ndër vite dhe kështu të perceptohen si thjesht administrative dhe jo motivuese. Duhet të futen risitë dhe ndryshimet, ndërsa instrumentet të testohen dhe përmirësohen vazhdimisht. Ekziston nevoja e kujdesit të veçantë për të mos e shndërruar rritjen e cilësisë në kontroll të cilësisë pasi nganjëherë ekziston një dallim i vogël ndërmjet tyre. Qëllimi përfundimtar është motivimi dhe shpërblimi i atyre që bëjnë punën më mirë, por ky lloj menaxhimi i performancës mund të shihet gjithashtu si një kontroll i tepërt.

Mundësitë:

- Kultura e fortë e SC-së tashmë e krijuar;
- Përvojë e mirë me IEP-në;
- Mekanizmat e SC të përfshira në strategjitë e promovimit dhe motivimit;
- Shembuj të praktikës së mirë të gatshme në dispozicion në Evropë.

Sfidat:

- Nevojë për inovacion të rregullt për të parandaluar lodhjen me instrumentet e SC-së;
- Stafi mund të jetë më proaktiv në propozimin e seancave të dëshiruara të zhvillimit Universitetit;
- Studentët dhe stafi duhet të sigurohen përsëri për anonimitetin e anketave të vlerësimit.

8. Mësimdhënia dhe të mësuarit

8.1 Programet dhe statusi

Gjatë periudhës së këtij rishikimi, UEJL ka ofruar studime të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në të gjithë pesë fakultetet. Në programet magjistraturës dhe doktoratës ndiqen leksionet në klasë dhe më vonë bëhet hulumtimi dhe përpilimi i tezës për të cilën organizohet mbrojtje formale publike. Të gjitha tezat e magjistraturës dhe doktoratës së UEJL-së janë mentoruar nga mentorë të akredituar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe janë pothuajse gjithmonë staf i UEJL-së.


Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Universiteti ndërmori përpjekje të konsiderueshme për të theksuar të menduarit kritik dhe kompetencat digjitale në kurrikula. Ndër elementët e tjerë të kësaj përpjekje ishin azhurnimet dhe harmonizimi i kurrikulave, për të theksuar komponentët e të menduarit kritik në lëndë dhe përfshirja e elementeve të mësimit digjital dhe detyrave të vlerësimit. Të gjitha lëndët në të tre ciklet tani kanë një prani digjitale (*Google Classroom*).

Të dhënat në vazhdim përshkruajnë ciklin e jetës studentore nga regjistrimi deri në diplomim.

8.2 Regjistrimi i studentëve

Grafikoni 1, paraqet të dhënat totale të regjistrimit për vitet akademike 2017-18, 2018-19 dhe 2019-20. Siç mund të shihet, regjistrimet mbeten afërsisht të qëndrueshme nga viti në vit. Viti akademik 2019-2020 ka parë një rritje të dukshme të regjistrimit, i cili është një sukses i mrekullueshëm, duke pasur parasysh presionet demografike dhe emigruese mbi të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.


Viti akademik	Regjistrimet
2017-18	957
2018-19	959
2019-20	1013



Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm sipas viteve akademike

Grafikoni 2, paraqet numrin e regjistrimeve sipas gjuhës së studimeve. Të dhënat paraqesin disa tendenca të qarta. Studimi në gjuhën shqipe vazhdon të jetë në mënyrë të konsiderueshme oferta akademike më e popullarizuar e Universitetit, pasuar nga vendi i largët i dytë i studime në gjuhën angleze; sidoqoftë, studimet në gjuhën angleze ende përbëjnë mbi 20% të udhëzimeve gjuhësore sipas gjuhës së studimit. Në mënyrë shqetësuese, regjistrimet për mësim në gjuhën maqedonase kanë rënë në nën 10% të regjistrimeve, gjë që ka pasoja të konsiderueshme për misionin social dhe pedagogjik të Universitetit.


Gjuha e studimeve	VA 2017-18	%	VA 2018-19	%2	VA 2019-20	%3
Shqip	665	69%	678	71%	701	69.2%
Anglisht	239	25%	195	20%	236	23/3%
Maqedonisht	53	6%	68	9%	76	7.5%
Total	957	100%	959	100%	1013	100%



Graf 2. Numri total i regjistrimeve sipas gjuhës së studimeve

Grafikoni 3, raporton numrin total të regjistrimeve sipas fakulteteve për 3 vitet akademike të fundit. Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë mbetet fakulteti më i madh me regjistrimin e studentëve, megjithëse në VA 2019-2020, pati një rënie prej 21 studentësh për atë fakultet. Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore dhe Fakulteti i Drejtësisë patën rritje të konsiderueshme në regjistrimin e studentëve në VA 2019-2020, në krahasim me vitin paraprak akademik, siç bëri (me modesti) Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimeve. Fakulteti me numër më të vogël me regjistrimin studentëve mbetet Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore.

Fakulteti	VA 2017-18	VA 2018-19	VA 2019-20
BE	247	265	244
SHTB	175	163	212
Drejtësisë	217	170	190
SHSHB	99	141	146
GJKK	219	220	221
Total	957	959	1013



Graf 3. Numri total i regjistrimeve sipas fakulteteve

8.3 Kalueshmëria e studentëve


Kalueshmëria dhe diplomimi i studentëve janë përcaktues thelbësorë nëse universiteti ka sukses ose ka dështuar. Ndërsa disa studentë mund të tërhiqen për arsye të jashtme nga përpjekjet e tyre akademike (sëmundje, martesë, vështirësi familjare, financa), është bindja e Universitetit të Evropës Juglindore, që çdo student që regjistrohet përfundimisht duhet të diplomojë.

Grafikoni 4, paraqet të dhënat që lidhen me diplomimin në kohë. Këto të dhëna janë aktuale dhe flasin për gjendjen deri më 5 dhjetor 2019. Diplomimi në kohë përcaktohet si përqindja e studentëve që përfundojnë studimet e tyre në periudhën trevjeçare të synuara nga kurrikula akademike. Një tendencë mbetet shqetësuese: shumë studentë që arrijnë vitin e tyre të tretë nuk diplomojnë në fund të atij viti.

VA 2015-16 Deridiplomike						
Fakulteti	Regjistrimi 1-rë Viti	Gjenerata 2-të		Gjenerata 3-të Viti		Të diplomuar
		Viti	%	%2	%2	
BE	142	130	92%	109	77%	21
SHTB	109	91	83%	71	65%	48
Drejtësi	138	123	89%	107	78%	66
SHSHB	114	96	84%	86	75%	76
GJKK	98	82	84%	73	74%	68
Total	601	522	87%	446	74%	279

VA2016-17 Deridiplomike						
Fakulteti	Regjistrimi 1-rë Viti	Gjenerata 2-të Viti	%	Gjenerata 3-të Viti	%2	Të diplomuar
BE	132	116	88%	107	81%	45
SHTB	93	81	87%	73	78%	17
Drejtësi	112	98	88%	95	85%	32
SHSHB	105	79	75%	73	70%	36
GJKK	103	83	81%	80	78%	39
Total	545	457	84%	428	79%	169

VA2017-18 Deridiplomike					
Fakulteti	Regjistrimi viti 1-rë	Gjenerata viti 2-të	%	Gjenerata viti 3-të	%2
BE	133	111	83%	96	72%
SHTB	106	85	80%	64	60%
Drejtësi	120	88	73%	78	65%
SHSHB	51	42	82%	36	71%
GJKK	80	62	78%	61	76%
Total	490	388	79%	335	68%



Graf 4. Kalueshmëria dhe Diplomimi në kohë sipas Fakulteteve (VA 2017-18)

8.4 Qendra e karrierës dhe punësueshmëria

Qendra e karrierës së UEJL-së parqet ndihmë të vazhdueshme për studentin gjatë gjithë kohës së studimeve në UEJL dhe në fakt edhe pas diplomimit. Qendra e karrierës ofron trajnim në punë, ndihmë për aplikim, trajnim simulues për intervistë, ndihmë për përpilimin e CV-së, mundësi për punë praktike dhe këshilla dhe shpërndan njoftimet për vendet e lira të punës. Qendra e karrierës, gjithashtu, organizon panairin vjetor të karrierës, në të cilin më shumë se dyzet punëdhënës të ndryshëm vendosin pulcet e tyre për të kontaktuar me punëmarrësit e mundshëm në mesin e studentëve të interesuar. Më në fund, Qendra e karrierës është pika kryesore e kontaktit që kanë të diplomuarit me Universitetin dhe ajo zakonisht kryen anketime me të diplomuarit për të mësuar mbi statusin e tyre të punës (të dhënat e prezantuara këtu për punësimin rrjedhin nga ky studim).

Të dhënat tregojnë se shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve për vitin 2017, (grupi më i fundit i të diplomuarve të anketuar), është 59.87% dhe shkalla e atyre që nuk janë punësuar është 40,13%. Sidoqoftë, ky numër është disi mashtrues, pasi kombinon të dy ato grupe p.sh. të papunë, por që kërkojnë punë dhe ata që janë të papunësuar në mënyrë vullnetare (zakonisht për arsye të shëndetit, martesës ose maternitetit); kur vullnetarisht të papunët nuk merren si faktorë, shkalla e punësimit është afërsisht 68%. (Të tjerët të papunë janë ata që vazhdojnë studimet e tyre sepse nuk mund të gjejnë punë.)

Kur merret në konsideratë aspekti individual sipas fakulteteve, shkalla më e lartë e punësimit të të diplomuarve është nga Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore (me 92.60%) i ndjekur nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë (76.50%) dhe Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit (70%). Shkalla më e ulët e punësimit gjendet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore Bashkëkohore (62.20%) dhe Fakultetin e Drejtësisë, i cili raporton punësim prej (54.10%).

Të marra individualisht, të diplomuarit - meshkuj kanë më shumë të ngjarë të punësohen sesa të diplomuarit - femra; meshkujt raportojnë një normë punësimi prej 74.60%, ndërsa femrat raportojnë një normë punësimi prej 65.80%.

Kur ekzaminohen në këndvështrimin e gjuhës së programit të studimit, të diplomuarit e programeve në gjuhë shqipe raportojnë punësim prej 68.50%. Të diplomuarit e programeve në gjuhën maqedonase raportojnë punësim prej 74.10%. Të diplomuarit e programeve në gjuhën angleze raportojnë punësim prej 79.40%.

Shkalla më e lartë e punësimit gjendet në mesin e studentëve që diplomohen me notë mesatare midis 9-10; ata raportojnë shkallë punësimi prej 75.00%. Shkallë më të ulët të punësimit kanë studentët që diplomojnë me notë mesatare midis 6-7; ata raportojnë një shkallë punësimi prej 61.70%. Këto të dhëna sugjerojnë që Universiteti po bën punën e vlerësimit në mënyrë të krahasueshme me kërkesat e bëra nga tregu i punës.

Duhet të theksohet se të gjitha këto të dhëna rrjedhin nga vetë-raportimi nga ata të diplomuar të cilët zgjedhën për t'iu përgjigjur sondazheve të Qendrës së karrierës dhe nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur për saktësinë pa shkelur privatësinë dhe konfidencialitetin e të diplomuarve.

8.5 Asociacioni Alumni

Pasiviteti i asociacionit Alumni është një humbje kritike dhe e shmangshme për Universitetin. Një asociacion efektiv i të diplomuarve mund të sigurojë mundësi të vlefshme punë praktike/ punësim për të diplomuarit; këshillojnë stafin akademik të universitetit dhe politikë-bërësit për kurrikulat, ndërtimin e shkathtësive dhe tregun e punës; promovimin e Universitetit në komunitetin e përgjithshëm; dhe të sigurojë një aleat të vlefshëm rekrutimi për përpjekjet e regjistrimit të studentëve të UEJL. Asnjë nga këto gjëra nuk po ndodh.

Për të adresuar këtë mundësi të humbur, në periudhën e këtij raporti, UEJL filloi një iniciativë të re për qasjen e alumnive. Është shumë shpejt për të përcaktuar se sa efektive, ose e qëndrueshme do të jetë kjo iniciativë, por është një përpjekje e parë për të rindërtuar marrëdhëniet e nevojshme — dhe të dobishme reciprokisht — midis Universitetit dhe alumnive të tij.

9. Hulumtimi

Hulumtimi është një përpjekje e konsiderueshme e Universitetit të Evropës Juglindore, duke qenë një shtyllë thelbësore e ciklit të dytë dhe të tretë të studimeve dhe një nga elementët kryesorë të matjes së performancës akademike për stafin mësimdhënës. Studentët që studiojnë në programet e

magjistraturës dhe doktoratës kërkohet për të përfunduar një tezë të bazuar në hulumtime dhe për ta mbrojtur atë në një provim zyrtar akademik publik; Gjithashtu, nga studentët e doktoratës, kërkohet që të publikojnë të paktën dy (2) punime akademike në revista akademike të recensuara nga kolegët para se të lejohet të planifikohet mbrojtja. Stafi akademik, gjithashtu, i kërkohet të botojë punimet e tyre në revista akademike të recensuara nga kolegët dhe portfolio që rezulton nga hulumtimi i botuar është një element thelbësor në procesin e promovimit akademik.

Për të mbështetur dhe monitoruar këtë produktivitet hulumtues, puna hulumtuese e stafit akademik të UEJL-së vlerësohet vazhdimisht nga Komiteti Qendror i Hulumtimit. Anëtarët e këtij Komiteti kanë një mandat dy vjeçar . Përbërja aktuale e KQH u aprovua në dhjetor të vitit 2018 dhe filloi me punë në janar të vitit 2019. Gjatë periudhës së këtij raporti KQH vazhdoi procesin e vlerësimit të rregullt të punës hulumtuese të stafit akademik, me një ritëm të rritur takimesh dhe vendimesh. Që nga implementimi i këtij ritmi të rishikuar të mbledhjeve të KQH-së, KQH ka arritur të vlerësojë plotësisht punën hulumtuese të stafit akademik të Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë; Fakultetit të Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore; dhe Fakultetit të Drejtësisë; dhe ka krijuar listat përkatëse të revistave dhe konferencave të aprovuara që stafi akademik këshillohet të marrë pjesë ose të botojë punën e tyre.

Vendimi për shpërndarjen e Fondit të Hulumtimit dhe Zhvillimit Personal (FIHVP), prezantoi Procedurën e përdorimit të FIHVP-së, e cila filloi të zbatohet nga 1 nëntori 2018, me të drejtën e përdorimit deri më 31 gusht 2019.

Në periudhën e mbuluar nga ky raport ishin 109 kërkesa të paraqitura nga stafi akademik për pjesëmarrje në konferencë rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare; 8 kërkesa të paraqitura për botimin e punimeve shkencore në revista rajonale dhe ndërkombëtare; dhe 5 kërkesa të paraqitura për pjesëmarrje në trajnime të ndryshme profesionale në Zyrën e Hulumtimit. Shumica e stafit e përdorën Fondin për pjesëmarrje dhe publikim të punimeve hulumtuese në konferenca ndërkombëtare. Të gjitha kërkesat u rishikuan dhe u regjistruan nga Zyra e Hulumtimit dhe u miratuan ose refuzuan nga Prorektorja për Hulumtime dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare. Në raste kur kërkesat janë refuzuar, zakonisht refuzoheshin sepse revista ose botuesi i përfshirë njihej si një botues grabitqar, ose sepse konferenca është identifikuar si një ndërmarrje thjesht tregtare dhe kështu vlerësohej se mungonte merita akademike. Në raste të tilla, Zyra e Hulumtimit dhe Prorektorja për Hulumtime dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare e kanë këshilluar aplikantin të kërkonte mundësi më cilësore dhe e kanë ndihmuar atë për ta bërë këtë.

Shuma totale e përdorur nga Fondi për Hulumtim dhe Zhvillim Individual është 33837 euro. Fondet u ndanë nga fakultetet ose qendrat, kështu: Biznesi dhe Ekonomia 7870 euro; Shkencat & Teknologjitë Bashkëkohore 7442 euro; Qendra e Gjuhëve — 7305 euro; Shkencat Shoqërore Bashkëkohore — 6150 euro; Gjuhët, Kulturat dhe Komunikimi — 3518 euro; dhe Juridiku — 1552 euro.

Në lidhje me propozimet e projekteve hulumtuese në nivelin e Universitetit, në periudhën e këtij raporti ishin 17 aplikime për projekte të ndryshme kombëtare dhe evropiane/ndërkombëtare të hulumtimit dhe financim kërkimor. Në mesin e propozimeve ndërkombëtare, për programin e projektit 'ERASMUS + KA1 Jean Monnet', u paraqit një kërkesë dhe ne presim informatë kthyesë; UEJL është në rolin partnerit në këtë projekt. Në mënyrë të ngjashme, për Horizon H2020, UEJL ka paraqitur tre aplikime nga të cilat dy ishin aprovuar dhe një është në pritje; UEJL-ja është përsëri në rolin e partnerit në këto tre projekte. Shumica e aplikimeve të stafit të UEJL-it ishin drejt thirrjeve të programeve ERASMUS + KA2, nga të cilat nga gjithsej 7 aplikime, dy u aprovuan, dy u refuzuan dhe tre u vendosën në listën e rezervave.

Universiteti, gjithashtu, dorëzoi propozime projektsh për programet e disponueshme në nivelin kombëtar, në të cilat e ka rolin kryesor. Dy aplikime janë dorëzuar në Ministrinë e Kulturës të RMV-së, nga të cilat një është aprovuar dhe një është në pritje të vendimit. Propozim-projekti, gjithashtu, u dorëzua në

Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së për një projekt dypalësh me Ministrinë Kineze të Shkencës dhe Teknologjisë me titull "Bashkëpunim Shkencor dhe Teknologjik midis Maqedonisë – Kinës"; të dy projektet u miratuan dhe do të fillojnë në janar të vitit 2020. Universiteti ka rolin kryesor në këto projekte.

Propozime shtesë për projekte u dërguan në përgjigje të thirrjeve nga Iniciativat e Evropës Qendrore (CEI) dhe Komisioni Evropian - Fakulteti i Shoqërisë Civile dhe Programi i Mediave 2018-2019, të dyja janë në pritje të vendimeve.

E fundit, Universiteti ka revistën akademike në lidhje me elementet kryesore të hulumtimit dhe mësimdhënies së pesë fakulteteve të UEJL-së, e titulluar "SEEU Review". Kjo revistë recenohet nga kolegët, pa pagesë ndaj kontribuuesve dhe publikohet online pa abonim, ose kosto për çdo lexues.

Mundësitë:

- Stafi i përkushtuar me përvojë në rritje në hulumtime serioze ndërkombëtare;
- Rritja e suksesit në aplikimin për projekte/financim të hulumtimit;
- Mbështetje e konsiderueshme hulumtuese e dhënë nga UEJL për stafin akademik;
- Ritmi i rritur i rishikimeve në KQH lejon mbikëqyrje dhe ndihmë për hulumtuesit/studuesit.

Sfidat:

- Konferencat që nuk kanë vlefshmëri dhe revistat pa kuptim po bëhen gjithnjë e më të sofistikuara në thirrjet e tyre për punime, duke e bërë gjithnjë e më të domosdoshme që hulumtuesit e UEJL-së të jenë skeptikë dhe vigjilentë rreth asaj ku ata ndajnë hulumtimet e tyre;
- Hapësirë për përmirësime ekziston në koordinimin e hulumtimit dhe mësimdhënies;
- Hulumtimi akoma i stimuluar drejt performancës individuale dhe jo projekteve bashkëpunuese;
- Infrastruktura modeste e mbështetjes (laboratorët, bazat e të dhënave, ekspertizë për hartimin e granteve), rezulton në një numër të pamundshëm të aplikacioneve hulumtuese.

9.1 Instituti hulumtues "Maks van der Shtul"

Instituti i hulumtues "Maks van der Shtul" është njësi kryesore e Universitetit të Evropës Juglindore për organizimin e hulumtimit bashkëpunues në Universitet. Edhe pse shumica e hulumtimeve individuale janë kryer nën kujdesin e fakulteteve individuale, IHMVDS organizon seminare, punëtori dhe konferenca për të promovuar hulumtimin kolegial dhe grupor, konkretisht në fushat e lidhura ngushtë me fakultetet e Universitetit — shkenca sociale, diskursin politik, biznes dhe tregti, gjuhë dhe gjuhësi, dhe çështjet juridike.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky vlerësim, IHMVDS përmirësoi kapacitetet administrative dhe kërkimore të Institutit duke ndërmarrë një ristrukturim të caktuar administrativ dhe organizativ. Në mënyrë të veçantë, Instituti filloi të përdorë strategji të efektshme të menaxhimit dhe duke identifikuar nevojën për një bashkëpunëtor hulumtues me përvojë të fortë ndërkombëtare. (Ky person ishte punësuar, por pak pas periudhës së këtij shqyrtimi; nevoja për pozicionin ishte avancuar proceduralisht gjatë kësaj periudhe). Funksionimi i Institutit gjithashtu u rregullua me rregulloren e re për punën e Këshillit të IHMVDS, e cila rregullore u miratua nga Senati; është emëruar Këshilli, i cili tani funksionon. IHMVDS ka rishikuar dhe azhurnuar ueb faqen e tij.

Instituti ka vazhduar punën e tij të organizimit të tubimeve, të tilla si tryeza të rrumbullakëta, mundësi të rrjetëzimit dhe diskutimeve. IHMVDS, gjithashtu, ka pritur disa mysafirë vizitues përmes Programit të Lartë të Hulumentimit *Fulbright*, si dhe vizitë-ligjëruese studentore nga Universiteti i Varshavës. Për më tepër, IHMVDS rriti ndjeshëm numrin e aplikacioneve për projekte dhe grante për të cilat aplikoi dhe iu dha një projekt H2020, si dhe një projekt nacional i sponsorizuar nga Ministria e Kulturës. Më në fund, IHMVDS e hartoi një koncept -dokument për potencialin hulumtues të Institutit dhe UEJL-së në përgjithësi, për institucionet partnere ndërkombëtare.

Mundësitë:

- Një bashkëpunëtor i ri hulumtues duhet t'i zgjerohë kapacitetet e Institutit;
- Projektet kanë filluar të fitohen, duke ndërtuar përvojë thelbësore të aplikimit;
- Është emëruar një Këshill i IHMVDS dhe i njëjti është thirrur.

Sfidat:

- Stafi mbetet i gatshëm të ndjek hulumtimet përmes IHMVDS;
- Orientimi i UEJL-it ndaj shkencave shoqërore kufizon projektet e mundshme të hulumtimet;
- Kufizimet buxhetore e bëjnë problematike hulumtimin në shkallë të gjerë ose afatgjatë.

10. Marrëdhëniet ndërkombëtare

Universiteti i Evropës Juglindore ka qenë i orientuar ndërkombëtarisht që nga themelimi, gjë që u imponua nga kombet e shumta donatore dhe organizatat ndërkombëtare (siç është OSBE-ja). Universiteti ka pasur fatin të ketë bashkëpunim me institucione të shquara partnere ndërkombëtare, nga të cilët më i spikaturi është Universiteti Indiana nga SHBA-të. Përputhshmëria ndërkombëtare dhe krahasueshmëria e ofertës arsimore të UEJL-së dhe njohja ndërkombëtare e diplomës së UEJL-së, kanë qenë gjithmonë konsiderata kryesore e palëve të interesuara të Universitetit. Për këto arsye, Marrëdhëniet Ndërkombëtare mbeten një element kryesor i identitetit institucional dhe qëllimeve të ardhshme të UEJL-së.

Gjatë periudhës së këtij raporti, një nga elementët kryesorë ndërkombëtarë të përpjekjeve të Universitetit ka qenë t'i shfrytëzojë fondet dhe mundësinë e dhënë nga Komisioni Evropian përmes programit Erasmus +. Gjatë vitit akademik 2018/19, UEJL-së iu nda një numër i përgjithshëm prej 76 grantesh për mobilitet nga të cilat u zbatuan një numër i përgjithshëm prej 58 grantesh për mobilitet: 44 grante për mobilitet të studentëve dhe 14 grante për mobilitet të stafit. Shumica e granteve studentore ishin grante për mobilitet, të cilat mundësuan që studentët të kalojnë një semestër në një universitet me të cilin UEJL ka nënshkruar marrëveshje Erasmus +. Disa grante të mobilitetit të studentëve konsistojnë në grante internshipi, të cilët u mundësuan studentëve të marrin pjesë në programet e praktikës me kompani, ose universitete në vendet me të cilat UEJL ka marrëveshje Erasmus +. Grantet e internshipit u zbatuan për herë të parë gjatë këtij viti akademik. Qëllimi i UEJL-së është të rritet numri i studentëve që përdorin këto grante, pasi kjo përvojë mund të jetë shumë me ndikim për karrierën e tyre. Për më tepër, UEJL ka nënshkruar 9 marrëveshje të reja Erasmus + gjatë vitit 2018/19 dhe ka pritur 3 studentë dhe 7 profesorë dhe staf. Për sa i përket aftësisë për të zbatuar grantet e akorduara nga programi Erasmus +, UEJL qëndron në pozitën e dytë në nivel të Maqedonisë së Veriut. Grantet e mobilitetit të stafit janë zbatuar në një nivel 100%, ndërsa grantet për mobilitet studentor janë zbatuar me një normë relativisht të lartë.

Në lidhje me bashkëpunimin me universitetet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjatë vitit akademik 2018/19, UEJL nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Indianës Jugore,

Universitetin Shtetëror Montana, Billings dhe Universitetin Shtetëror Kent. UEJL-i rinovoi lidhjen me Universitetin Indiana, një institucion, i cili ka qenë mbështetësi kryesor i zhvillimit të UEJL-së që nga themelimi i tij. Një marrëveshje e re bashkëpunimi me Universitetin Indiana është në zhvillim, e cila synon të krijojë një strategji për bashkëpunim më të ngushtë midis dy institucioneve. Në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me universitetet amerikane, një sfidë e vazhdueshme është gjetja e fondeve për të mbështetur shkëmbimin. Prandaj, qëllimi i bashkëpunimit me Universitetin Indiana është identifikimi i projekteve dhe zhvillimit të ideve të përbashkëta që do të bënin të mundur një shkëmbim dhe bashkëpunim të tillë. UEJL-ja priti studiuesin pasuniversitar Fulbright dhe asistentin e mësimdhënies së anglishtes Fulbright gjatë 2018/19.

UEJL ka nënshkruar 7-të marrëveshje të reja të ndërsjella me universitete të ndryshme gjatë vitit akademik 2018/19. Disa nga këto marrëveshje synojnë të rinovojnë bashkëpunimin me universitetet tradicionale partnere rajonale ndërsa marrëveshjet e tjera kanë të bëjnë me bashkëpunimet e krijuara rishtazi.

Mundësitë:

- Pjesëmarrje e fortë në Erasmus + nga studentë dhe stafi;
- Bashkëpunim i përtërirë me partnerin tonë historik Universitetin Indiana;
- Dallimi rajonal e bën UEJL një partner tërheqës ndërkombëtar;
- Vullnet i mirë kah ndërkombëtarizimi nga studentët dhe stafi.

Sfidat:

- Financimi i duhur për bashkëpunim ndërkombëtar është gjithmonë i vështirë për t'u siguruar për gjithë institucionet rajonale të arsimit të lartë;
- Mundësitë për mobilitet studentorë Erasmus + nuk duhet të lehen pa u shfrytëzuar;
- Maqedonia e Veriut nuk shihet si një destinacion tërheqës për mobilitet “ardhës”;
- UEJL mbetet e angazhuar për të identifikuar më shumë staf ndërkombëtar për lëndë modulare, mysafir dhe stafin mësimor ndërkombëtar me kohë të plotë.

11. Ndërmarrësia dhe zhvillimi

Meqenëse UEJL ka statusin juridik unik të të qenit institucion i arsimit të lartë “publik-privat-jo-fitimprurës”, është veçanërisht i vendosur për t'u bërë ura lidhëse në mes botës sipërmarrëse dhe akademike. Universiteti është njëkohësisht entitet studiues dhe ndërmarrje sipërmarrëse (ka nevojë të paguajë kostot e veta). Prandaj është një shqetësim thelbësor i komunitetit të Universitetit që ne të mbajmë qëndrueshmëri të fortë financiare si një institucion akademik, ndërsa të vazhdojmë të krijojmë inovacione për të përmbushur nevojat e partneritetit evoluues të bashkëpunëtorëve komercial, bashkëpunëtorëve sipërmarrës, agjencive jo qeveritare dhe partnerëve qeveritarë ndërkombëtarë.

Iniciativat e ndërmarrësisë dhe zhvillimit të Universitetit ndjekin zhvillimin e shumëfishtë, duke theksuar veçanërisht: 1) qëndrueshmërinë e besueshme të Universitetit si një partner i vlefshëm i biznesit dhe tregtisë, dhe 2) zhvillimin e shkathtësive tek studentët që promovojnë iniciativën krijuese si dhe gatishmërinë bashkëkohore të tregut të punës (punësueshmëria). Kjo lidhje e synuar e akademikëve-punëdhënësve-industri synon të sigurojë bazën e të diplomuarve më të besueshëm të fuqisë punëtore në rajon, si dhe të ndikojë në modernizimin dhe racionalizimin e programeve studimore të universitetit.

Për të përmbushur këto nevoja të të dyja palëve: universitetit dhe partnerëve komercial, Universiteti ka themeluar Qendrën e Biznesit dhe Inovacionit (Business & Innovation Centre -BIC), e cila bashkon Qendrën për Zhvillimin e Biznesit të Universitetit (QZHB) dhe Parkun Teknologjik të UEJL-së. Parku Teknologjik u themelua në vitin 2013 dhe është përpjekja kryesore e Universitetit për të nxitur sipërmarrjen e jashtme dhe të diplomuarve me mentorimin e komunitetit akademik. I vendosur në një ndërtesë të veçantë në kampusin e Tetovës, Parku Teknologjik u ofron kompanive fillestare asistencën, lehtësirat dhe prestigjin e Universitetit në një periudhë të rëndësishme të inkubacionit të tyre korporativ. Në të kundërt, Universiteti përfiton duke nxitur bizneset e reja në momentet fillestare të krijimit të tyre dhe përshtatjes me realitetet e tregut. Kjo u mundëson këtyre iniciativave të angazhojnë një forcë pune të arsimuar, t'i qasen kapitalit sipërmarrjes dhe të bashkëpunojnë me Universitetin. Për periudhën e mbuluar nga ky raport, Parku Teknologjik ka 13 kompani të reja qiramarrësish, 4 prej tyre të reja pikërisht këtë vit, të cilat kanë hapur më shumë se 150 vende pune të reja të teknologjisë në treg dhe kanë siguruar më shumë se 3.000 m2 hapësirë të veçantë për aktivitetet e sipërmarrjes.

Qendra për Zhvillimin e Biznesit është pika e synimit dhe dëshirës së UEJL-së për të ofruar ekspertizën e vet dhe këshilla për biznesin vendor dhe komunitetin korporativ. QZHB ofron mundësi për planifikim biznesor, trajnim të stafit, ushtrime të menaxhimit ekzekutiv, konsulencë, asistencë për zgjerimin ose optimizimin, organizimin e seminareve dhe mundësi për rrjetëzim. QZHB-ja kërkon të sigurojë qasjen e Universitetit dhe reputacionin në komunitetet lokale të Tetovës dhe Shkupit në dispozicion të komunitetit të korporativ. Lista që vijon nuk është aspak një listë gjithëpërfshirëse e partnerëve të fundit, QZHB është krenar që ka punuar kohët e fundit me: Dauti Komerc; Alkaloid; Sparkasse Bank; NB Construction; Ecolog; Harbini Cosmetics; dhe Mercure Hotels.

QZHB synon, që në vitet e ardhshme, të përqendrohet në disa nisma kryesore për zhvillim: 1) ofrimin e vazhdueshëm të trajnimit dhe konsulencës për bizneset dhe industrinë vendore; 2) pritja e vazhdueshme e ndërmarrjeve *start up* në Parku Teknologjik; 3) zhvillimi i një Fondi TechPark, në thelb për të siguruar nxitjen e sipërmarrësve premtues, por që nuk kanë fonde të mjaftueshme; 4) për të përfshirë gjithnjë e më nga afër botën e biznesit dhe punësimin me dizajnin e programeve studimore dhe këshillim.

Universiteti beson fuqimisht në ndërmarrësi dhe nxitja e biznesit është një fushë kryesore për zhvillimin e ardhshëm, pasi thellon angazhimin tonë në komunitet, ndihmon të diplomuarit tanë të fillojnë të përparojnë idetë e tyre dhe të ndihmojnë UEJL-në për të garantuar burime të ndryshme dhe rrjedhëse të të ardhurave.

Mundësitë:

- Reputacion i mirë lokal dhe mbështetje e fortë në kampus;
- QZHB harmonizon në mënyrë të dobishme përpjekjet dhe entitetet sipërmarrëse;
- Ndihmon të diplomuarit dhe UEJL-në, duke promovuar bashkëpunimin e vazhdueshëm edhe pas diplomimit;
- Mund të diversifikojë rrjedhën e të ardhurave.

Sfidat:

- Përpjekjet e mëparshme të trajnimit dhe konsulencës mbetën sfidë;
- Stafi duhet të inkurajohet të ndjekë bashkëpunimin përmes dhe me BIC.

12. Financimi

Duke qenë institucion i arsimit të lartë privat-publik jo-fitimprurës, financimi i aktiviteteve të mësimdhënies dhe hulumtimit të Universitetit gjithmonë ka qenë me rëndësi të madhe për suksesin e UEJL. Ky financim është mbështetur kryesisht nga fondet e vetë institucionit dhe pjesërisht nga të ardhurat e jashtme. Në këtë kontekst shumica e të ardhurave rrjedhin nga pagesa e studentëve. Kjo pjesëmarrje e të ardhurave nga pagesa e shkollimit me këtë nivel ka të ngjarë të mbetet në të ardhmen e afërt, duke bërë atë si burim kryesor të të ardhurave për Universitetin. Burime shtesë të të ardhurave kanë origjinën në aktivitetet e shërbimeve të tjera universitare (duke ofruar trajnime për kompanitë e jashtme ose hartimin e programeve zhvillimore për bizneset). Një burim tjetër financimi i operacioneve të Universitetit është buxheti i shtetit, i cili për të pestin vit radhazi ka vazhduar të subvencionojë Universitetin, këtë vit me një rritje prej afër 40% dhe regjistrim si entitet fiskal në Buxhetin e RMV-së. Ky hap i ndërmarrë nga Qeveria e RMV-së ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm në ruajtjen e ofrimit të arsimit me cilësi të lartë nga UEJL. Interesi nga depozitat bankare afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe investimet në fondet e investimeve me rrezik të ulët janë një shtesë tjetër në buxhetin e Universitetit.

Toka në të cilën ndodhet kampusi i Tetovës nuk i përket Universitetit apo Fondacionit, por Qeverisë dhe përdoret në bazë të një marrëveshje afatgjate.

Nëse ne kemi një vështrim të afërt në portfolion e të ardhurave për vitin akademik 2018/2019, është si më poshtë: pagesa e shkollimit paraqet 82.50% e të ardhurave, të ardhurat komerciale janë 2.50%, aktivitetet financiare janë 0.40%, projektet 0.60% dhe subvencionet nga shteti janë pjesa e mbetur 14.00%.

PJESA E MJETEVE NGA BUXHETI NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas të dhënave më të fundit, totali i mjeteve të Universitetit është 1,149,217,000 MKD. Për vitin akademik 2018/2019, në bazë të raportit për realizim të buxhetit, të ardhurat e përgjithshme nga pagesa e shkollimit ishin 204,841,000 MKD. Të ardhurat totale për atë vit ishin 252,015,000 MKD.

PJESA E MJETEVE NGA PAGESA SHKOLLIMIT NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas numrave, pjesëmarrja e pagesave të studentëve në totalin e mjeteve për vitin akademik 2018/2019, është 17.82%.

Mundësitë:

- Vazhdimi i qëndrueshmërisë financiare në rrethana të vështira;
- Mbështetja e vlefshme qeveritare e rriti qëndrueshmërinë në këtë periudhë;
- Përpjekjet për optimizimin financiar kanë ulur kostot.

Sfidat:

- Mbështetja e vazhdueshme në pagesat e shkollimit dhe subvencionet qeveritare në nivel të 96.50% të të ardhurave;
- Infrastruktura e amortizuar imponon kosto shtesë të zëvendësimit ose mirëmbajtjes;
- Zhvillimi i mëtutjeshëm i të ardhurave komerciale, projekteve dhe aktiviteteve financiare duhet të ndiqet jo vetëm në BIC, por përmes të gjitha organeve të tjera të Universitetit.

13. Mjedi dhe shërbimet në kampus

13.1 Mbështetja studentore

Mbështetja e studentëve kryesisht është realizuar nëpërmjet Shërbimeve studentore dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët, për vitin akademik 2018/2019, janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të Universitetit, programit “Punë dhe studime”, sponsorizime nga komuniteti i biznesit dhe nëpërmjet programit financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të familjes. Nga numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në studime deridiplomike, gjithsej 26.4% prej tyre financiarisht janë përkrahur në një farë mase.




Figura 1

Bursat jepen në bazë të meritës dhe meritat vlerësohen nga performanca akademike e studentit. Në nivelin e Universitetit janë dhënë 316 bursa, pra rreth 19,8% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt. Ato mbulojnë tarifën e pjeshme dhe të plota të programit përkatës të studimit.

Nga pikëpamja financiare, rreth 2.7% e studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit “Punë dhe studime”. Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të Universitetit, duke përfituar nga përvoja relevante, por edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 43 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje e pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit janë mbështetur 63 studentë, çka përfaqëson 3.9% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevojë të veçanta dhe mundësisë për bursa për këtë grup të studentëve.

UEJL në bashkëpunim me komunitetin e biznesit ka dhënë 29 bursa që mbulojnë 100% të pagesave të shkollimit në programe të ndryshme. Kjo është dëshmuar si një shtesë e vlefshme për instrumentet

ekzistuese për mbështetjen e studentëve dhe kjo do të ndihmojë për të ruajtur lidhjet e forta me kompanitë që duan të mbështetin studentët e UEJL-së me bursa.

13.2 Ngrehinat dhe kapacitetet teknike

Universiteti tashmë po e arrin fillimin e dekadës së tretë së ekzistuari dhe kapacitetet e tij mbeten po të njëjta dhe të mirëmbajtura në çdo aspekt. Pamja e tij vazhdon të jetë shembull institucional jo vetëm brenda shtetit, por edhe në rajon. Kjo është kryesisht për shkak të punës shembullore të stafit të Shërbimit të mirëmbajtjes, të cilët sigurojnë që të gjitha kapacitetet teknike, logjistika dhe hapësirave të menaxhohen siç duhet dhe që të gjitha pasuritë në pronësi të Universitetit të mirëmbahen si duhet.

Universiteti, në kampusin në Tetovë, vazhdon investimin në sisteme të reja, të cilët e rrisin efikasitetin dhe evidencën në njërin anë dhe optimizojnë kostot operative në anën tjetër. Departamenti i menaxhimit të mirëmbajtjes në vazhdimësi ndjek trendet moderne të një standardizimi permanent dhe këtë vit, në bashkëpunim me institutin për hulumtim “Max Van Der Stoel” piloton projektin “*smart classroom*”, i cili është kryekëput ide “*in-house*” dhe do të duhet të jep rezultatet e para të automatizimit komplet të të gjitha objekteve në fillim të vitit 2020.

Departamenti i mirëmbajtjes ndjek hapin e arritjes së objektivave të caktuara nga menaxhmenti, duke i respektuar përpikërisht standardet dhe duke i avancuar ato gjithmonë në kuadër të plotësisht të kushteve optimale për të gjithë marrësit e shërbimit. Studentët dhe stafi akademik mbeten shfrytëzuesit kryesor të shërbimeve të mirëmbajtjes, duke i ndjekur standardet për kushte më tepër se optimale për punë. Kapaciteti hapësiror i garantuar për çdo student, kushtet e sigurisë dhe shkëlqyeshmëria e shërbimit vazhdojnë të jenë prioriteti i shërbimeve të mirëmbajtjes. Në përpikëri departamenti vazhdon të mbajë ambientin si të jashtëm ashtu edhe të brendshëm me notë të lartë të vlerësimit nga ana edhe e stekholderëve tanë.

Konceptet e reja, të inkuadruar këtë vit akademik, përfshijnë zhvillimin e zonave të tilla si menaxhimi i energjisë, krijimi i ideor i kornizës për menaxhim të aseteve, evidenca detale e të gjitha shërbimeve të dhëna dhe optimizimi i proceseve në pajtueshmëri me procedurat sipas standardeve ndërkombëtare. Ky proces, siç është dëshmuar në organizata më të mëdha do të sjell rezultate edhe në ruajtjen e vazhdueshme të aseteve, parandalimin në kohë të incidenteve të mundshme nga pajisjet dhe lehtësimin e zëvendësimit të tyre.

Departamenti vazhdon me realizimin e objektivave të reduktimit të kostove duke i zëvendësuar në vazhdimësi shpenzuesit standard me shpenzues të klasifikuar si efikas të tipit A+. Ky implementim kryesisht ka vazhduar në ndërrimin permanent të dritave led, ndriçimin publik, dhe automatizimin e kontrollit të dritave në çdo objekt.

13.3 Kampusi i UEJL-së në Shkup

Megjithëse kampusi kryesor i UEJL-së mbetet kampusi i shkëlqyer i Tetovës, Universiteti gjithashtu drejton një kampus me të gjitha shërbimet në kryeqytet, në Shkup. Kampusi i Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup ndodhet në një pozitë simbolike në ndërtesën të quajtur “ura” që lidh pjesën e vjetër dhe të re të kryeqytetit, është një nga institucionet arsimore më qendrore në kryeqytet, si dhe ofron të gjitha shërbimet dhe mbështetjen e studentëve që janë në dispozicion të studentëve të kampusit të Tetovës. Dallimi i vetëm i dukshëm midis ofertave akademike midis Tetovës dhe Shkupit është se në kampusin e Shkupit ofrohen vetëm studime të ciklit të parë dhe të dytë; studentëve të doktoratës u kërkohet të ndjekin ligjëratat e tyre në Tetovë.

Për shkak të vendndodhjes qendrore, UEJL Shkup ka qenë shpesh vendi pritës për konferenca, tryeza të rrumbullakëta, punëtori, dhe ligjërata të organizuara nga Universiteti. Si dy shembuj të kësaj tendence, mund t'i përmendim vetëm konferencën "Biznes engjëjt në Maqedoni" të organizuar në UEJL Shkup (në bashkëpunim me CEED Maqedoni) dhe konferencën e Fakultetit të Biznesit dhe Ekonomisë "Nga tranzicioni në zhvillim", mbajtur në Shkup - UEJL. Aktivitet tjera që u organizuan në kampusin e Shkupit në vitin 2019, përfshinë finalet për shkollat fillore dhe të mesme të konkursit "Spelling Bee", (ku nikoqir ishte Qendra e gjuhëve në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Ohrit dhe Korpusin e Paqes.), po ashtu, u realizua *English Filmmaking Camp*, nga Qendra e Gjuhës në bashkëpunim me NGO 'Koreni'. Të gjitha këto aktivitete dhe ngjarje shërbyen për qëllime të dyfishta për të ofruar mundësi intelektuale dhe shkëmbim të ideve për studentët e Kampusit të Shkupit, dhe njëkohësisht ndihmuan për promovimin e Universitetit në tregun më të madh demografik të vendit.

Gjithashtu, në periudhën e mbuluar nga ky raport janë bërë përpjekje të konsiderueshme për të rritur gjenerimin e të ardhurave përmes negociatave të favorshme për kontratat e nevojshme të shërbimit. Këto do të përfshijnë aranzhime të reja për vendndodhjen e hapësirës së bankomateve (ATM), në pronën e Universitetit; marrëveshje të reja për makineri shitëse të ushqimit dhe kafes; dhe rinegociimin e orëve të personelit të sigurimit dhe stafit të pastrimit dhe mirëmbajtjes. Edhe pse këto rezultojnë në ulje relativisht të vogla të kostos, besohet se çdo kursim, sado i vogël, është i vlefshëm dhe parqet vrull për optimizim të dobishëm. Kampusi i Shkupit gjithashtu siguroi 6.000-7.000 euro për BIC-në nga dhënia me qira e hapësirave të Kampusit disa OJQ-ve për organizim të konferencave dhe trajnimeve. Drejtori i Shkupit dhe drejtorja e tij mbeten të përkushtuar të kërkojnë mundësi për të ulur kostot lokale dhe për të rritur gjenerimin e të ardhurave.

Në periudhën e mbuluar nga ky raport, filloi projekti i ri 'Alumni për Universitetin dhe Universiteti për Alumnin', përmes të cilit studenti i UEJL-së, Ejup Ahmeti (pronar i kompanisë ndërkombëtare 'Doni Fruits'), dhuroi 10 kompjuterë në kampusin e Shkupit, në mënyrë për të lehtësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve.

Është bërë përpjekje maksimale që të përforcohet bashkëpunimi me ndërmarrjet publike të Qytetit të Shkupit. Gjatë muajit qershor 2019, është siguruar një donacion prej diku rreth 1.700 euro nga Qyteti i Shkupit, gjegjësisht NP 'Parqe dhe gjelbërime', për rregullimin e mini-parkut të Kampusit, ku është instaluar sistemi pikë-në-pikë për ujitje, janë mbjellë lule të llojeve të ndryshme, bredha dhe prodhime tjera të hortikulturës. Po ashtu, NP 'Higjiena komunale' ka siguruar pesë vende për punë praktike, ku studentët nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë për një muaj kanë qëndruar në këtë ndërmarrje dhe kanë realizuar punën praktike në sektorin e financave.

13.4 Burimet njerëzore

Me qëllim të sigurimit të burimeve njerëzore adekuate dhe cilësore edhe gjatë vitit akademik 2018-2019 Zyra e Burimeve Njerëzore ka vazhduar që konform kompetencave dhe autorizimeve të luaj rol të rëndësishëm në udhëheqjen dhe menaxhimin e procesit të rekrutimit të stafit, si dhe procesin e promovimit akademik. Të gjitha këto procese janë përmbyllur me sukses dhe në kohë, si rrjedhojë gjatë këtij viti Universiteti rekrutoi 2 anëtarë të stafit administrativ dhe promovoi 22 anëtar të stafit në thirrje akademike (5 Profesorë Ordinar, 11 Profesorë Inordinar dhe 6 Docentë).

Gjatë vitit akademik 2018-2019, të punësuar janë 244 punonjës të Universitetit të Evropës Juglindore. Ata janë të shpërndarë si në tabelën më poshtë. Ka 139 anëtarë të stafit akademik, 96 prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 43 të tjerë janë të punësuar me kohë të pjesshme. Janë 105

staf administrativ, prej të cilëve 102, janë të punësuar me kohë të plotë dhe 3 janë të punësuar me kohë të pjesshme.

Në vazhdim të dhëna tabelare lidhur me stafin akademik dhe administrativ:

Tabela 1. Thirrjet mësimore – shkencore/profesionale/bashkëpunëtor për stafin akademik në marrëdhënie të rregullt pune:

Titulli mësimor –shkencor/profesional/ bashkëpunëtor	F. Drejtësisë	SHSB	BE	SHTB	GJKK	QGJ	eLC
Profesor Ordinar	3	7	3	2	6		
Profesor Inordinar	4	3	10	13	5		1
Docent	5	2	6	2	2		
Lektor i lartë						18	
Lektor					1		
Bashkëpunëtor	1	1	1				

Tabela 2. Thirrjet shkencore për stafin akademik në marrëdhënie të rregullt pune për tre vitet e fundit:

Titulli Shkencor	2016 / 2017	2017 / 2018	2018/2019
PhD	77	75	79
MA	25	20	17
BA	0	0	0

Tabela 3. Kualifikimi për tre vitet e fundit për stafin administrativ në marrëdhënie të rregullt pune

Titulli Shkencor	2016 / 2017	2017 / 2018	2018/2019
PhD	4	5	5
MA	18	16	15
BA	61	59	57

Numri më i lartë i të punësuarve në shtatë vitet e fundit është regjistruar në vitin 2012, kur kishte një total prej 347 të punësuarish (254 me kohë të plotë dhe 93 me kohë të pjesshme). Këta numra janë ulur në mënyrë të vazhdueshme edhe atë si rezultat i optimizimeve, pensionimeve ose dorëheqjeve. Këto trende janë si në vazhdim: në vitin 2013, gjithsej kishte 320 të punësuar, nga të cilët 249, me kohë të plotë dhe 71, me kohë të pjesshme. Në vitin 2014, gjithsej kishte 300 të punësuar, nga të cilët 229, me kohë të plotë dhe 71, me kohë të pjesshme. Në vitin 2015, gjithsej kishte 285 të punësuar, nga të cilët 223, me kohë të plotë dhe 62, me kohë të pjesshme. Në vitin 2016, gjithsej kishte 278 të punësuar, nga të cilët 221, me kohë të plotë dhe 57, me kohë të pjesshme. Në vitin 2017, gjithsej ka pasur 261 të punësuar nga të cilët 205, me kohë të plotë dhe 56, me kohë të pjesshme dhe në vitin akademik 2018, gjithsej ka pasur 244 të punësuar nga të cilët 198, me kohë të plotë dhe 46, me kohë të pjesshme.

Stafi	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Full-time	254	249	229	223	221	205	198
Part-time	93	71	71	62	57	56	46
Total	347	320	300	285	278	261	244

13.5 Sistemet e informacionit

Gjatë këtij viti akademik stafi i Sistemeve të Informacionit ka punuar në pasurimin dhe zgjerimin e platformave dhe procedurave elektronike në mënyrë që t'u shërbejë studentëve, stafit akademik dhe stafit administrativ. Në këtë drejtim, sistemi elektronik i Modullit të Diplomimit (Graduation Module), është zgjeruar për të përfshirë kërkesat e studentëve në Studime Specialiste (*Specialistic Studies*). eGrading është zgjeruar dhe janë ridefinuar rregullat e biznesit për afatet e futjes dhe shpalljes së notave në eGrading. Kjo ka rezultuar në një shkallë më të lartë të afateve të plotësuara për futjen e notave gjatë seanceve të provimeve.

Sistemi elektronik i prokurimit është zgjeruar gjithashtu. Me kërkesë të Qendrës së Inovacionit dhe Biznesit, sistemi është zhvilluar në mënyrë që kjo njësi brenda institucionit të mund të shërbehet përmes platformës elektronike të prokurimit. Kjo ka ndihmuar në optimizimin e prokurimit brenda BIC. Për më tepër, si rezultat i kërkesës së BIC-it për fillimin e sistemit elektronik të arkivit edhe në këtë njësi Universitare, gjithashtu është modernizuar sistemi elektronik i arkivit.

Stafi i Sistemeve të Informacionit kanë vazhduar me migrimin e sistemit UMS në WEB aplikacion. Në këtë drejtim vlen të theksohet zhvillimi dhe futja në përdorim i disa raporteve elektronike, specifike për shërbimin e mirëmbajtjes, me qëllim të menaxhimit sa më të mirë gjatë optimizimit të shpenzimeve për ngrohje.

Në kuadër të portalit elektronik MySEEU stafi i Sistemeve të Informacionit ka punuar që i njëjti të pamundësojë qasje në disa shërbime të caktuara në vend se studentit t'i mbyllet llogaria e qasjes në rrjetin kompjuterik të Universitetit. Kjo i ka mënjanuar problemet që i kishim në të kaluarën kur studentët si rezultat i bllokimit të llogarisë nuk ishin në gjendje të ndjekin ligjëratat të caktuara.

Sa i përket pjesës së infrastrukturës kompjuterike këtë vit stafi i Sistemeve të Informacionit ka punuar në pastrimin dhe mënjanimin e pajisjeve të vjetra elektronike. Është kontrolluar çdo hapësirë në të dyja kampuset dhe janë mënjanuar të gjitha pajisjet e vjetra dhe të panevojshme që zinin hapësirë dhe shpenzonin energji elektrike pa nevojë. Është riorganizuar dhe optimizuar tërësisht edhe shërbimi i printimit. Është reduktuar numri i pajisjeve për printim dhe është implementuar sistemi për matje të sasisë së printimit për secilin përdorues në veçanti. Kjo, ka rezultuar me ulje të konsiderueshme të shpenzimeve për printim duke mos e cenuar shërbimin e printimit.

Për shkak se Universiteti mbetet një institucion rajonal i pashembullt i digjitalizimit akademik dhe përfshirjen e teknologjisë në proceset mësimore dhe hulumtime, stafi i Shërbimeve të Informacionit vazhdon ta konsiderojë punën e tyre si veprim që kërkon nivelin më të lartë të përkushtimit dhe profesionalizmit

13.6 Shërbimet e bibliotekës

Biblioteka "Maks van der Shtul", si bibliotekë institucionale e Universitetit të Evropës Juglindore është e vendosur në lokacion të përshtatshëm në ndërtesën 702, e cila është me hapësirë prej 565 m², duke përfshirë këtu: sallat e leximit, sallën për mbledhje ose mësim në grup, sallën kompjuterike, hapësirën për debat. Në të njëjtën mënyrë me të gjitha shërbimet funksionon edhe biblioteka në Kampusin e UEJL-së në Shkup. Të pavarur nga biblioteka qendrore, në UEJL funksionojnë edhe bibliotekat degë në Fakultetet e Universitetit dhe biblioteka shumë mirë e organizuar në Qendrën e Gjuhëve.

Për funksionim të suksesshëm të të gjitha operacioneve bibliotekare e shfrytëzojmë programin (softuer), PMB, i cili është një sistem i integruar i bibliotekës me qasje të hapur. Në të, rregullisht bëhet

sinkronizimi i të dhënave me bazën qendrore të UEJL-së dhe automatikisht gjenerohen llogaritë e përdoruesve. PMB gjithashtu ka në funksion edhe katalogun online me qasje të hapur (OPAC).

Gjendja momentale e tërë koleksionit të bibliotekës është si në vijim: 32,858 libra në bibliotekën në Tetovë dhe 3094 libra në bibliotekën e kampusit në Shkup, numri i përgjithshëm 36,465 libra. Numri i përgjithshëm përfaqëson 17,403 tituj të ndryshëm (pjesa tjetër janë kopje të shumta të atyre titujve). Biblioteka është gjithashtu deponues kryesorë i Universitetit për disertacionet dhe tezat e mbrojtura me sukses, nga të cilat biblioteka mban e 143 disertacione (51 elektronike); 374 teza (303 elektronike), për një total prej 517 punimesh të rëndësishme studentore (354 elektronike).

Në periudhën kohore që përfshin ky raport janë siguruar të gjitha materialet e duhura për studentët dhe stafin, gjegjësisht biblioteka është furnizuar me tituj të rinj të propozuara nga Komiteti i Bibliotekës. Janë katalogizuar afro 870 tituj përfshi aty edhe 417 teza dhe disertacione të të gjithë studentëve të diplomuar në studimet pasuniversitare në UEJL. Shumë me rëndësi është të ceket që kemi qasje të rregullt vjetore në bazat e të dhënave elektronike si: EBSCO, EconBiz, Akademika dhe Edward Elgar Publishing Journals, si dhe njëkohësisht janë ofruar qasje shtesë në pesë baza të të dhënave elektronike për periudhë të caktuar deri në tre muaj. Në bibliotekë në dispozicion janë edhe materialet informative të printuara nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara, si dhe Banka Botërore për të cilët është siguruar një kënd i veçantë.

Biblioteka, gjithashtu, shërben si vend qendror për shfaqje publike të tezave të magjistraturës dhe doktoratës në pritje të mbrojtje, të cilat janë vënë në dispozicion të publikut, ose raportet e recensioneve për proceset e promovimit për titull akademik. Duhet theksuar se, falë bashkëpunimit me sekretaret e fakulteteve dhe me ndihmën e zyrës së TI-së për herë të parë nga ky vit është digjitalizuar procedura për shqyrtim publik të tezave master dhe disertacioneve. Nga Fakulteti përkatës kopjet elektronike publikohen (për shqyrtim) në Thesis Repository, ku të interesuarit kanë qasje lokale nga hapësirat e Bibliotekës në Tetovë dhe Shkup, me afat të caktuar me rregullore.

Në mënyrë permanente janë organizuar aktivitete dhe prezantime për studentët e rinj dhe trajnime për studentët në studime pasuniversitare për burimet e informacionit që i ofron biblioteka, gjithashtu edhe për mënyrën e përdorimit të bazave të të dhënave elektronike. Falë prezantimeve të suksesshme kemi rritje të përdorimit të katalogut online të bibliotekës, sidomos të versionit mobil, ku ka rritje prej 10700 vizitorëve.

Leximoret e Bibliotekës “Maks van der Shtul” janë të hapura edhe për publikun në periudhën kohore që përfshin ky raport, gjegjësisht në vitin akademik 2018/2019, janë anëtarësuar 70 studentë të jashtëm dhe njëkohësisht janë shërbyer edhe të gjithë studentët e jashtëm të akomoduar në konviktet e UEJL-së.

Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare (BKU) në Shkup, veçanërisht sigurimin e numrave ISBN, ISSN dhe CIP (Cataloguing in publication), për botimet e reja, ku si botues është UEJL-ja. Bashkëpunimi me BKU-n ka vazhduar edhe me aktivitete tjera profesionale, si anëtarë të Konzorciumit të Bibliotekave Publike të RMV-së, si anëtarë të IFLA-s dhe si anëtarë të Asociacionit të Bibliotekave të RMV-së.

13.7 Parlamenti dhe Asociacioni Studentor

Parlamenti dhe Asociacioni Studenti është organi zyrtar i zgjedhur i përfaqësuesve të studentëve. Studentët e të gjitha cikleve lejohen të garojnë për zgjedhje në PAS dhe vetë zgjedhjet mbikëqyren nga një grup i stafit akademik dhe administrativ të UEJL-së të emëruar nga Drejtoria e Rektoriale. Pasi të jenë zgjedhur kandidatët e suksesshëm, atëherë pason votim i brendshëm në PAS-së për të përcaktuar se kush

do të shërbejë si oficer në Parlamentin Studentor, më së shumti për pozitën e Kryetarit të PAS-së, Nënkryetarit të SPA-së dhe Sekretarit të SPA-së. Sipas rregullores së Universitetit, kryetari dhe zëvendës-kryetari vijnë nga kampuse të ndryshme. Ekziston pozicioni i jashtëm i Avokatit (Ombudspersonit) Studentor, i cili nuk shërben në PAS, por gjithashtu mban një pozitë të rëndësishme të avokimit të studentëve dhe i cili është gjithashtu - si anëtarësia parlamentare - i zgjedhur direkt nga studentët.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Parlamenti Studentor vendosi përqendrimin e tij kryesor në përfaqësimin e studentëve në fusha akademike dhe arsimore, siç është ofrimi i këshillave dhe ndihmës në rastet kur studentët ndjehen të mbingarkuar nga detyrimet e tyre, ose mbase kundërshtojnë vlerësimin e punës së tyre. Për më tepër, PAS-së ka bërë një përpjekje të bashkërenduar për të zgjeruar ofertat kulturore dhe sociale në dispozicion për studentët, veçanërisht duke themeluar disa klube bazuar në interes të përbashkët, ose shqetësim shoqëror: për shembull, PAS-së ka vazhduar ose ka themeluar klube të natyrave të ndryshme si Klubin Etik, Klubin e Debatit, Klubin Feminist dhe Klubin Sportiv. PAS gjithashtu ka vazhduar të mbështesë revistën studentore “Euroidea” dhe ka vazhduar ofrimin e mundësive për argëtim dhe ekskursion për studentët.

13.8 Sporti dhe rekreacioni

Si çdo vit tjetër edhe këtë vit akademik (2018/2019), Sektori për sport dhe rekreacion në kuadër të UEJL-së ka qene mjaft aktiv në shërbim të studenteve dhe stafit , për organizimin e aktiviteteve sportive në shume sporte, duke iu mundësuar të shfrytëzojnë kapacitetet dhe kushtet që i ofron Universiteti për zhvillimin e këtyre aktiviteteve sportive.

Në kampus çdo ditë janë organizuar aktivitete intensive sportive në futboll, volejbol, basketbol, fitnes, tenis, shah, ping-pong dhe kurse për vallëzim dhe joga për të gjithë studentet dhe stafin. Në orët e vona të mbrëmjes është bërë kyçja e reflektorëve në mënyrë që studentët të mund pa pengesa t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre sportive. Përveç këtyre aktiviteteve të cilat janë të përditshme, ka patur edhe aktivitete të cilat organizohen periodikisht edhe atë: turnirë të ndryshme në futboll, ping-pong dhe shah. Vlen të theksohet edhe organizimi i turneut në futboll të vogël për shkollat e mesme të Tetovës që tashmë tradicionalisht organizohet në kampusin e Universitetit. Për ndër të festave të nëntorit, si dhe për nder të përvjetorit të themelimit të UEJL-së, Sektori për sport, organizoi turnirin tradicional “MEMORIALI-ARBËR XHAFERI”.

Po ashtu, ekipi i futsallit ishte pjesëmarrës në Ligën e Maqedonisë në futball, ku e përfaqësoi UEJL-në. Stafi i UEJL-së, morri pjesë në Ligën institucionale Komunale të Tetovës në futboll të vogël. Me studentët ishim pjesëmarrës në garat ndëruniversitare në sporte të ndryshme. Gjithashtu, ishim nikoqir i garave republikane në ping-pong, të organizuara nga Federata e ping-pongut.

Është me rëndësi të theksohet se Sektori për sport ka organizuar edhe turnirë në ping-pong dhe futboll edhe për studentët e UEJL-së në Shkup. Për të siguruar kushte të mira për sport për studentët e UEJL-së Shkup , kemi nënshkruar kontratë për shfrytëzimin e sallës dhe pishinës “Boris Trajkovski”, të cilën studentët kanë mundur ta shfrytëzojnë për sport dhe rekreacion.

14. Konkluzionet dhe rekomandimet

Ndërsa Universiteti i Evropës Juglindore i afrohet dekadës së tretë të ekzistencës, ai mund të krenohet me vlerën e kontributit të tij në jetën individuale të stafit dhe studentëve dhe për rolin më të madh shoqëror që ka luajtur në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Mbetet një nga institucionet e pakta të arsimit të lartë në rajon i përkushtuar në mënyrë të shprehur në sigurimin e arsimit konkurrues ndërkombëtar, në të tre ciklet, pavarësisht përkatësisë etnike, gjuhës amtare, fesë, gjinisë, kombësisë, apo

bindjeve politike. Vlera e këtij angazhimi për misionin reflektohet në shumë aspekte të jetës së Universitetit - larmia e studentëve dhe stafit që zgjedhin të jenë këtu; modelin e diversitetit dhe përsosmërisë arsimore të ofruar nga institucioni; suksesin e të diplomuarve dhe stafit në tregjet me konkurrencë ndërkombëtare; dhe masën bujare të subvencionit qeveritar për të ndihmuar në vazhdimin e punës.

Megjithatë, çdo institucion i këtij fushëveprimi dhe madhësie duhet të ketë dështime që kanë nevojë për vlerësim serioz dhe përpjekje serioze ose për të eliminuar apo për të përmirësuar të njëjtat. Gjatë procesit të përpilimit të të dhënave dhe dëshmimeve për këtë vlerësim, fushat e mëposhtme të shqetësimit u ngritën në shumë mjedise. Ata meritojnë konsideratë serioze nga menaxhmenti i Universitetit, stafi, studentët dhe alumni, pasi që shumë nga këto sfida kërkojnë përpjekje të koordinuar nga i gjithë komuniteti i Universitetit:

- mirëmbajtja ose rritja e regjistrimit të studentëve në studimet deridiplomike, pa e ulur cilësinë;
- mirëmbajtja e liderishipit rajonal në programet e ciklit të dytë dhe të tretë, pa ulur cilësinë;
- të merret në konsideratë zbatimi i standardeve themelore për pranim në konkursin për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve;
- diversifikimi i flukseve të të ardhurave për të zvogëluar varësinë joproporcionale nga pagesat e shkollimit dhe subvencionet qeveritare;
- të vazhdohet me përpjekjet e optimizimit për të identifikuar shpenzimet e shmangshme;
- të inkurajohet stafi të bashkëpunojë me QBI (BIC) dhe TechPark për të identifikuar fushat përmes të cilave Universiteti mund të ofrojë shërbime për komunitetin e jashtëm;
- të përmirësohet niveli i diplomimit në kohë;
- riaktivizimi i studentëve — veçanërisht studentëve të magjistraturës dhe doktoratës— të cilët janë bërë joaktivë;
- të përafrojmë me vigjilencë kurrikulat dhe ofertat e lëndëve me nevojat e tregut, për të përmirësuar nivelet e punësimit të të diplomuarve;
- rithemelimi i një asociacioni Alumni aktiv dhe dinamik;
- të synohet gjenerimi i pjesëmarrjes më të suksesshme në projektet hulumtuese, ose marrje të granteve, përmes Zyrës së Hulumtimit dhe Institutit të Hulumtues ‘Maks van der Shtul’;
- të bëhet promovimi në thirrje akademike më sfidues dhe më pak ‘automatik’;
- të rritet stafi mësimdhënës ndërkombëtar përmes kontratave me kohë të plotë;
- të identifikohen fushat e bashkëpunimit të mundshëm midis fakulteteve, për të kombinuar ofertat e kurseve aty ku është e mundur (për sa i përket lëndës dhe gjuhës së ofrimit);
- të merren në konsideratë zgjerimi i qasjes në bazën e të dhënave hulumtuese, veçanërisht për studentët e ciklit të dytë dhe të tretë dhe stafin.

Universiteti vazhdon të sigurojë një shembull të fortë rajonal për vlerën e diversitetit dhe suksesin e një atmosfere gjithëpërfshirëse arsimore. Suksesi i studentëve dhe stafit vërteton se UEJL mbetet një vend i përkushtuar për vlerat e misionit të tij, dhe të themeluesve të tij, ku mund të merret një arsim me

cilësi të lartë, pavarësisht nga gjinia, gjuha amtare, besimi fetar ose përkatësia politike. Megjithatë, është gjithashtu dallimi i UEJL-së që pranon hapur sfidat dhe vështirësitë e tij, si dhe Komisioni i Vetëvlerësimit, i cili i vëren këto dobësi në mënyrë të hapur, duke shpresuar të angazhojë kreativitetin, inovacionin dhe forcën e komunitetit të Universitetit për të identifikuar zgjidhjet.

15. Mirënjohje

Komisioni dëshiron gjithashtu tu shpreh mirënjohje për kontributin e dhënë Burim Ismailit për përmbajtjen e këtij raporti, si dhe Daniela Ilievskës dhe Rexhep Xheladinit për përkthimin dhe tu shpreh mirënjohjen e Komisionit për punën e tyre të palodhur.